



RADIO
TELEVISIONI
SHQIPTAR

www.rtsh.al

RAPORTI VJETOR I RTSH-SË PËR VITIN 2024



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

RAPORTI VJETOR I RTSH-SË PËR VITIN 2024

Drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Radio Televizioni Shqiptar

Raporti Ekzekutiv për vitin 2024

Në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së institucionit të shërbimit publik audioviziv për vitin 2024, ju paraqesim një përmbledhje të analizuar të situatës së Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), me qëllim pasqyrimin objektiv të performancës së tij dhe identifikimin e elementëve që kërkojnë ndërhyrje të posaçme në funksion të reformimit dhe modernizimit të mëtejshëm.

Gjatë vitit 2024, RTSH vijoi të përfaqësonte një ndër platformat më të mëdha dhe më të shtrira të komunikimit publik në vend, duke operuar me 16 kanale televizive dhe 11 radiofonike. Këto struktura mbuluan mbi 95 për qind të territorit dhe rreth 80 për qind të popullsisë shqiptare, duke e bërë RTSH-në një instrument kyç për informimin dhe edukimin e publikut. Redaksia e lajmeve ruajti kapacitetin e saj prodhues, duke gjeneruar mbi 50 kronika në ditë dhe tre reportazhe në javë, përfshirë edicione në gjuhë të huaja dhe në gjuhën e shenjave, duke respektuar standardet e cilësisë dhe balancës të përcaktuara nga EBU.

Performanca teknike e rrjetit transmetues ishte në nivel të lartë, me një shkallë disponueshmërie të sinjalit prej 99.92 për qind, çka garantoi mbulim të vazhdueshëm, veçanërisht për ngjarjet me rëndësi të veçantë kombëtare dhe ndërkombëtare. Në aspektin e diversitetit kulturor dhe gjuhësor, RTSH 2 vijoi transmetimin në tetë gjuhë të komuniteteve minoritare, ndërsa RTSH 3 dhe RTSH Shqip luajtën një rol të rëndësishëm për adresimin e diasporës dhe komuniteteve lokale. Struktura programore e RTSH 1 HD u karakterizua nga një balancë mes përmbajtjes argëtuese (28.6%), sociale (18.5%), kulturore (16.7%) dhe informative (11.9%), duke ruajtur misionin edukues dhe gjithëpërfshirës të medias publike. Bashkëpunimet ndërkombëtare me Zërin e Amerikës, RTK, Goethe-Institut, si dhe trajnimet me EBU dhe Deutsche Welle përbënin një aset të qëndrueshëm për zhvillimin profesional dhe teknologjik të institucionit.

Megjithatë, viti 2024 u shënua edhe nga një sërë sfidash strukturore dhe institucionale. Dorëheqja e Drejtorit të Përgjithshëm dhe më vonë shkarkimi i Këshillit Drejtues krijuan një periudhë paqëndrueshmërie që ndaloi përkohësisht zbatimin e objektivave afatgjata dhe la institucionin pa një drejtim strategjik të qartë. Struktura financiare mbeti e rënduar: mbi 52 për qind e buxhetit u dedikua për paga dhe sigurime shoqërore, duke kufizuar ndjeshëm investimet në përmbajtje dhe

teknologji. Një tjetër tregues shqetësues ishte mosrealizimi i fondit prej 12 milion lekësh të planifikuar për mbështetjen e prodhimeve të pavarura, i cili mbeti i papërdorur gjatë gjithë vitit. Përmbajtja e dedikuar fëmijëve dhe të rinjve vazhdoi të jetë e mangët, duke përbërë vetëm 3 për qind të programacionit total – një shifër e papërputhshme me praktikën dhe standardet evropiane. Gjithashtu, mungesa e transparencës në publikimin e shpenzimeve, strukturave organizative, punësimeve dhe vendimmarrjes së bordeve e dëmtoi besueshmërinë dhe llogaridhënien publike. Kanale të caktuara, si RTSH Shqip, RTSH Film dhe RTSH Plus, funksionuan kryesisht për rritjen e ritransmetimeve dhe pa një linjë editoriale të qartë, duke e zhvlerësuar diversitetin e ofruar në letër. Së fundi, institucionit iu desh të përballonte një barrë të rëndë financiare për shkak të detyrimeve nga vendime gjyqësore: mbi 63 milion lekë u likuiduan për procese të humbura, ndërkohë që mbi 95 milion lekë të tjera mbetën të ekspozuara ndaj rrezikut financiar nga çështje ende të hapura. Në analizë të fakteve dhe vendimmarrjeve të gjykatave, konkludohet se shumica e vendimeve të ish-Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me ish-punonjës të RTSH-së janë rrëzuar për shkak të mungesës së arsyeve të qarta, të dokumentuara dhe të ligjshme që justifikojnë largimin e punonjësit nga puna. Për rrjedhojë, institucionit të RTSH-së do t'i duhet të bartë për të ardhmen, një barrë shumë të madhe financiare që u shkaktua si rezultat i vendimeve të gabuara për përjashtim të pajustificuar nga puna të qindra profesionistëve e teknikëve nga ish-Drejtori i Përgjithshëm, e cila do të pengojë në mënyrë të konsiderueshme në të ardhmen e afërt reformimin e këtij institucioni.

Një nga potencialet më të rëndësishme të pazhvilluara ishte digjitalizimi i arkivës historike të RTSH-së në fund të vitit, vetëm 17 për qind e materialeve ishin digjitalizuar, duke përbërë një rezervë të rëndësishme për përdorim edukativ dhe tregtar në të ardhmen. Një tjetër çështje e pazgjidhur ishte mungesa e kontratës së shërbimit me Autoritetin e Mediave Audiovizive si dhe rritja e bashkëpunimeve ndërkombëtare me organizata si BE, EBU të cilët përbëjnë një burim të rëndësishëm për mbështetje teknike dhe financiare.

Gjithashtu, sfidat e jashtme për RTSH-në mbetën të shumta. Fragmentimi i tregut mediatik, rritja e ndikimit të rrjeteve sociale dhe e platformave private sfidoi ndjeshëm audiencën tradicionale të RTSH-së. Ndonëse platforma ofronte një numër të madh kanalesh, mungesa e burimeve për prodhim origjinal e bënte të pamundur përmbushjen e standardeve të programacionit të përditshëm në secilin kanal. Sistemet ekzistuese të IT-së dhe rrjetet transmetuese ishin të amortizuara dhe të papërshtatshme për një institucion të këtij niveli, duke rritur rrezikun për cenim të sigurisë kibernetike. Ndërkohë, 66 procese gjyqësore të hapura vijuan të rëndonin situatën financiare dhe të cenonin stabilitetin buxhetor. Mungesa e një kontrate shërbimi dhe e mbikëqyrjes së strukturuar nga AMA rrezikoi përmbushjen e misionit publik dhe të standardeve të transparencës.

Në përfundim, viti 2024 e gjeti RTSH-në në një gjendje të dyfishtë: nga njëra anë, me një potencial të padiskutueshëm për të ushtruar funksionin e tij si shërbim publik modern dhe gjithëpërfshirës, dhe nga ana tjetër, të zhytur në probleme të thella institucionale, financiare dhe teknologjike.

Në kushtet kur RTSH përballlet me paqëndrueshmëri drejtuese, performancë të dobët financiare dhe mungesë transparence institucionale, rekomandohet urgjentisht hartimi dhe miratimi i një Plani Strategjik afatmesëm 2025–2030, i shoqëruar me një ristrukturim buxhetor të thellë. Fondet duhet të ridrejtohen nga barra e lartë e shpenzimeve për paga drejt përmbajtjes origjinale, teknologjisë digjitale dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore. Po ashtu, duhet ngritur një ~~sinjal~~ e re për transparencë institucionale që të garantojë publikimin e të dhënave për vendimmarrjet, fondet, rekrutimet dhe bordet, si dhe për të përmbushur plotësisht detyrimet ligjore dhe kërkesat e Kuvendit.

Nga ana tjetër, RTSH duhet të përfitojë nga momenti i drejtimit të ri për të forcuar pozicionin e tij në tregun mediatik. Duhet investuar në identitet editorial për çdo kanal dhe në bashkëpunime me aktorë ndërkombëtarë. Ristrukturimi i kanaleve, digjitalizimi i arkivës dhe përdorimi i infrastrukturës për të ardhura të reja janë hapa kyç për qëndrueshmërinë. Paralelisht, adresimi i çështjeve gjyqësore në mënyrë transparente dhe reforma në sigurinë kibernetike janë thelbësore për të rikthyer besimin institucional dhe për të ndërtuar një transmetues publik modern, konkurrues dhe me integritet.

REZOLUTA E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Radio Televizionit Shqiptar për vitin 2023 dhe angazhimeve për vitin 2024

1. Të publikojë në faqe shpenzimet e festivaleve, si dhe shpenzimet për prodhimet e pavarura audiovizive, në funksion të transparencës për përdorimin e fondeve publike.

Nuk janë botuar në faqen web të RTSH-së.

2. Të informojë sa më parë Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në lidhje me arsyet e numrit të lartë të largimeve nga puna, numrin e rasteve që i janë drejtuar gjykatës dhe efektet financiare që kanë për institucionin këto largime.

Në zbatim edhe të pikës 2 të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Radio Televizionit Shqiptar për vitin 2023, RTSH ka patur paqëndrueshmëri drejtuese gjatë vitit 2024 dhe shpenzime të konsiderueshme financiare të paparashikuara si pasojë e proceseve gjyqësore të humbura me shumë ish-punonjës të larguar masivisht nga puna gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023 dhe deri në gjysmën e parë të vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, RTSH ka ndjekur 66 procese gjyqësore në të cilat ka qenë kryesisht palë e paditur me objekt "Marrëdhëniet e punës" dhe "Shkaktim dëmi".

Për vitin 2024 janë ekzekutuar vendimet gjyqësore me efekt të përkohshëm për 10 individë ish-punonjës, duke u likuiduar një shumë totale prej 63,312,954 lekësh. Këto pagues të marrëdhënies pavarësisht se ndaj këtyre vendimeve janë paraqitur ankime pranë Gjykatës së Apelit, të cilat aktualisht janë në shqyrtim.

Një sërë padish të tjera janë ndjekur në fazën e gjykimit në shkallë të parë. Në shqyrtim janë ende 24 çështje gjyqësore, të cilat kanë si objekt kryesor zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Pretendimet financiare të paditësve në këto raste kapin vlerën totale prej 45,968,337 lekësh.

Drejtoria Juridike ka ndjekur dhe depozituar në Apel edhe 42 çështje të tjera, ku pala paditëse ka fituar në shkallën e parë. Nëse Gjykata e Apelit do të konfirmojë vendimet përkatëse, RTSH mund të përballë me një detyrim shtesë në vlerën 95,743,246 lekë. Kjo shumë nuk përfshin penalitetet që mund të lindin më pas, siç janë kamatat vonesat, shpenzimet gjyqësore dhe tarifat përmbartimore.

Gjithashtu, pas shtatorit të vitit 2024, janë rikthyer në marrëdhënie pune 12 punonjës që ishin në proces gjyqësor, duke shmangur për momentin një detyrim potencial për RTSH në masën e 22,730,840 lekëve.

Në analizë të fakteve dhe vendimmarrjeve të gjykatave, konkludohet se shumica e vendimeve të ish-Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me ish-

punonjës të RTSH-së janë rrëzuar për shkak të mungesës së arsyeve të qarta, të dokumentuara dhe të ligjshme që justifikojnë largimin e punonjësit nga puna.

3. RTSH-ja t'u dedikojë një pjesë të fondit të prodhimeve të pavarura emisioneve për fëmijë e të rinj, me fokus të veçantë informimin dhe edukimin për fenomenin e bullizmit në këto grup-mosha.

Nga analiza e Drejtorisë Ekonomike, fondi i prodhimeve të pavarura për vitin 2024 nuk është realizuar fare. Fondi i prodhimit të pavarur, i planifikuar në vlerën 12,000,000 lekë nuk është shpenzuar gjatë vitit 2024.

4. Të bëhet transparente veprimtaria e KDRTSH-së në faqen zyrtare web duke publikuar të gjitha vendimet e marra, të shoqëruara me relacionet përkatëse, procesverbalet e mbledhjeve dhe mënyrën e votimit.

Duke filluar nga muaji Korrik 2024 janë botuar vendimet e Këshillit Drejtues RTSH dhe menyrat e votimit.

5. Të bëhet transparente përbërja dhe veprimtaria e Bordit të Administrimit, duke publikuar aktivitetin e këtij bordi dhe të gjitha vendimet e marra dhe aktet e miratuara.

Nuk janë botuar në faqen web të RTSH-së.

6. Të bëhet transparente përbërja dhe veprimtaria e Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit, si dhe të publikohen të gjitha vendimet e tij.

7. Të angazhohet në realizimin e më shumë emisioneve, programeve argëtuese, kulturore e edukative, prodhime të RTSH-së për të rinjtë, konkretisht për grup-moshat 10–14 vjeç, si dhe 15–18 vjeç.

Sipas raportit të Njësisë së programeve rezulton se programet me tematikë edukative për të rinj dhe për fëmijë përbëjnë vetëm 3.0% të totalit të programave të RTSH-së.

Mungesa e përmbajtjes së dedikuar për moshat e reja tregon një boshllëk që RTSH duhet ta adresojë. Programet për fëmijë shpesh perceptohen si “sektor i dytë”, me pak buxhet dhe staf të dedikuar. Nevojitet rikthim i vëmendjes strategjike në këtë fushë për ta ndryshuar këtë % dhe ta afruar tek standardet e enteve evropiane publike.

8. Të angazhohet për transmetimin e programeve edukative, të parashikuara në dispozitat e ligjeve specifike për mbrojtjen e shëndetit, siç është edhe ligji nr. 76/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar.

Nuk ka asnjë të dhënë në raport për këtë pikë.

9. Në “RTSH Kuvend” të përfshihen edhe përmbajtje informuese dhe shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave apo analizave profesionale me ekspertë të fushës për projektligje që janë në proces diskutimi, në funksion të konsultimit publik për aktet ligjore.

Përgjatë vitit 2024, RTSH Kuvend ka transmetuar drejtpërsëdrejt 1289 komisione parlamentare dhe 49 seanca parlamentare, si edhe 11 aktivitete të tjera të kryetares të Kuvendit. Po ashtu gjatë vitit 2024 janë transmetuar 15 episode nga një cikël emisionesh i titulluar "Dialog për Konsensus" me intervista dhe analiza nga parlamentarët për diskutimin e ligjeve me impakt për grupet e interesit. Për shkak se struktura e kanalit ka vetëm një redaktor përgjegjës, një gazetarë nga redaksia e lajmeve është vënë në dispozicion të këtij kanali për të ndihmuar në mbarëvajtjen e punës. Mungesa e një strukture të plotë e bën të pamundur realizimin e rekomandimeve që vijnë nga Kuvendi apo Autoriteti i Mediave Audiovizive për pasurimin e programacionit të këtij kanali.

10. Në kuadër të transparencës, të publikohet në faqen zyrtare struktura organizative dhe organika e RTSH-së, të shpallen vakancat e krijuara dhe të jetë transparente e gjithë procedura e rekrutimit deri në publikimin e fituesit.

Struktura organizative e RTSH-së nuk rezulton të jetë e publikuar në faqen zyrtare të RTSH-së, disa vende pune vakante janë publikuar vetëm gjatë vitit 2025.

11. KDRTSH-ja të investohet në hartimin e planit strategjik të institucionit për të siguruar qëndrueshmëri dhe vizion në drejtimin e transmetuesit publik.

Nuk është realizuar gjatë vitit 2024. Deri në vitin 2021 janë bërë disa përpjekje për hartimin e një Strategjie Zhvillimi të RTSH-së dhe Planit i Biznesit, por që mbeten të pafinalizuara me ndryshimin e drejtuesve në vitet në vazhdim.

12. Të angazhohet në digjitalizimin e arkivit të institucionit.

Nga raporti i veprimtarisë së Drejtorisë së Arkivës rezulton se ka nisur procesi i digjitalizimit të materialeve audio. Janë digjitalizuar materiale arkivore muzikore audio (Orkestra Simfonike e RTSH-së, Festivale të Rretheve, Konkurse të Zërave të Rinj, Takime të Ansambleve Amatore, Pjesërisht Festivale të Këngës në RTSH, Koncerte të Pranverës) dhe materiale arkivore audio nga Fondi i Folur (Teatri në Mikrofon, Fjala Artistike në Mikrofon, Emisione dhe Konkurse për Pionierë).

Gjithsej në total në periudhën janar – dhjetor 2024 janë digjitalizuar 71987 minuta (17 % e materialeve në total).

13. Të investojë në pajisjen me teknologji ndihmëse, me qëllim realizimin e programeve për personat me aftësi të kufizuara.

Nuk janë kryer investime të tilla për mungesë të fondeve financiare dhe gjendjes jo të mirë ekonomike të RTSH-së.

O

RAPORTI VJETOR ANALITIK I RTSH

Raporti në vijim paraqet një pasqyrë transparente, gjithëpërfshirëse dhe sa më afër realitetit të punës së RTSH-së, përgjatë vitit kalendarik 2024.

NJËSIA E PROGRAMEVE

Struktura programore

Aktualisht, RTSH operon një rrjet të gjerë transmetimi me 16 kanale audiovizive dhe 11 kanale radiofonike/audio, duke mbuluar mbi 95% të territorit dhe rreth 80% të popullsisë aktive në vend. Në thelb të programacionit të RTSH-së qëndrojnë tre shtyllat themelore të misionit të një transmetuesi publik: informimi i paanshëm, edukimi i publikut dhe ofrimi i përmbajtjes argëtuese me vlera.

RTSH 1 HD

Kanali gjeneralist RTSH 1 HD mbetet një nga pikat qendrore të rrjetit, duke ofruar për audiencën e gjerë një strukturë programore të balancuar dhe të ndërtuar mbi standarde editoriale.

Gjatë vitit 2024, RTSH 1 HD ka zbatuar një strukturë programore të tillë:

Programme me tematikë argëtuese (28.6%)

Pjesa më e madhe e programacionit i dedikohet përmbajtjes argëtuese. Emisione si Fustanella, E Diela Jonë, Një natë sa një jetë etj. kanë kombinuar elementet e show-t me panele diskutimi, rubrika argëtuese dhe humor duke shënuar dhe një rritje të ndjeshme të audiencës (shifrat nga klikimet në youtube dhe rrjetet sociale).

Dominanca e kësaj kategorie pasqyron përpjekjen e RTSH-së për të qëndruar konkurrues në treg mediatik ku kërkesa për përmbajtje argëtuese me nota humorit e spektakli është gjithnjë e në rritje. Sfida kryesore qëndron në ruajtjen e balancës mes cilësisë dhe popullaritetit, për të mos u larguar nga parimet themelore editoriale që një transmetuesi publik si RTSH-ja duhet të përmbushë.

Programme me tematikë sociale (18.5%)

Programet me tematikë sociale zënë një vend po aq të rëndësishëm. Emisione si Pasditja Ime, Trupi dhe Shëndeti, Aromë Gruaje, Auditor Arsimi adresojnë çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve, duke përfshirë barazinë gjinore, edukimin, mirëqenien dhe sfidat sociale. RTSH përmbush kështu një pjesë kyçe të misionit të vet publik. Megjithatë, sfida mbetet: si të thellohen këto përmbajtje pa u bërë didaktike apo klishe për audiencën më të gjerë.

Programme me tematikë kulturore (16.7%)

Programet kulturore mbajnë një vend të veçantë në strukturën programore. Emisione si Artes, Bibliotekë, Në Tempull, Rugëtimi Im, Kur shirohej një film, N'Fest 63, Mes Dy Botëve etj. ruajnë, promovojnë dhe risjellin pasurinë kulturore shqiptare. RTSH mbetet një institucion që jo vetëm dokumenton, por edhe rritet vlerat identitare përmes artit dhe kujtesës kolektive. Sfida e këtyre programeve është sjella e tyre në një formë më bashkëkohore dhe interaktive për të ngjallur interes edhe tek audiencia e re në moshë.

Programe me tematikë informuese (11.9%)

Formate që i kushtohen përmbajtjes informative si Jetë Shqiptare, Ekspres, etj. Këto janë formate të cilat analizojnë, komentojnë si dhe ndihmojnë publikun të kuptojë më thellë aktualitetin dhe realitetin shqiptar. RTSH diferencohet nga konkurrentët privatë, duke ofruar një vijë editoriale më të thelluar dhe më të balancuar. RTSH duhet të ripërshtasë përmbajtjen informuese për shumë platforma, jo vetëm për ekranin tradicional.

Programe me tematikë politike (10.3%)

Talk-show dhe programet politike zënë po aq një pjesë të rëndësishme programore. Emisione si 3D apo Pa Censurë ofrojnë platforma për diskutim të temave të rëndësishme politike e publike, me të ftuar nga politika dhe shoqëria civile. Sipas praktikave evropiane dhe rekomandimeve të EBU-së (European Broadcasting Union), programet politike, lajmet dhe analizat përbëjnë zakonisht 15–25% të totalit të programacionit të një kanali gjeneralist publik. Aktualisht, programet politike të mirëfillta zënë rreth 10% të totalit të minutazhit javor, që tregon një mungesë relative të theksit në këtë fushë krahasuar me standardet ndërkombëtare për një shërbim publik të plotë.

Programe me tematikë edukative për të rinj dhe për fëmijë (3.0%)

Kjo kategori është përfaqësuar nga 3 programe që përmbajnë elementë edukativë dhe argëtues që u dedikohet grup moshave të të rinjve dhe fëmijëve. Mungesa e përmbajtjes së dedikuar për moshat e reja tregon një boshllëk që RTSH duhet ta adresojë. Programet për fëmijë shpesh perceptohen si "sektor i dytë", me pak buxhet dhe staf të dedikuar. Nevojitet rikthim i vëmendjes strategjike në këtë fushë për ta ndryshuar këtë % dhe ta afruar tek standardet e enteve evropiane publike.

Programe me tematikë sportive (3.0%)

Programet dedikuar sportit dhe eventet sportive zënë një përqindje të vogël në programacion me gjithë interesin e lartë nga publiku. Një ndër sfidat më të mëdha në këtë drejtim është blerja e të drejtave ekskluzive për evente të rëndësishme, si kampionatet kombëtare e ndërkombëtare të futbollit, Formula 1, MotoGP apo Lojërat Olimpike. Këto nuk janë thjesht përmbajtje tërheqëse, por asete strategjike që rrisin audiencën, besueshmërinë dhe rolin publik të RTSH-së në tregun mediatik.

Festivali i Këngës

RTSH 1 HD vijon traditën e festivaleve muzikore me Fest 63, ngjarjen më të madhe muzikore në vend, që solli katër netë emocionuese me 30 këngë të reja live dhe të ftuar ndërkombëtarë. Në bashkëpunim me RTK, u transmetuan netët kryesore të FEST në RTK, Ndërkohë, Junior Fest Albania dhe Junior Eurovision 2024 përforcuan angazhimin e RTSH-së në zbulimin dhe mbështetjen e brezit të ri muzikor.

RTSH 2 HD

RTSH 2 HD është kanali që i jep zë Shqipërisë lokale dhe shumëgjuhëshe, duke reflektuar mozaikun e pasur të komuniteteve që e përbëjnë vendin. Me një fokus të qartë te lajmet rajonale, temat komunitare dhe minoritetet gjuhësore, ky kanal sjell në vëmendje realitetet e përditshme të çdo cepi të vendit, nga veriu në jug, duke përfshirë raportime në 8 gjuhë të minoriteteve të njohura me trashëgimi të veçantë kulturore. Ky kanal nuk është vetëm një dritare për realitetin lokal, por një hapësirë për njohjen, respektin dhe përfshirjen e diversitetit tonë etno-kulturor, duke pasuruar të gjithë shoqërinë shqiptare me zërin e atyre që shpesh mbeten në hije.

Struktura programore për RTSH 2 HD për vitin 2024, është si më poshtë:

- Edicioneve të rregullta lajmesh dhe reportazhe nga qendrat rajonale audiovizive të RTSH-së, si Shkodra, Korça, Kukësi dhe Gjirokastra.
- Emisioneve tematikë si “Transkulturë” (kulturë dhe sociale), “Art dhe Art” (arti pamor), “Receta e lumturisë” (wellbeing), “Dje dhe Sot” (tema sociale), “Sesion 31” (muzikë për të rinjtë).
- Transmetimit të përditshëm të lajmeve në 8 gjuhë minoritetesh dhe lajmeve javore në gjuhën e shenjave.
- Programit “360 gradë” me tre edicione informative ditore dhe transmetimit të “Zërit të Amerikës” deri në prill 2024.

RTSH 2 HD i dedikon 60% të hapësirës programore lajmeve dhe reportazheve nga çdo cep i vendit. Përmes kësaj qasjeje, kanali ofron një panoramë të thelluar të realitetit shqiptar, duke sjellë në ekran zërat, sfidat dhe zhvillimet e komuniteteve që shpesh mbeten jashtë vëmendjes së medias qendrore. Por, përtej raportimeve formale, RTSH 2 duhet të garantojë që komunitetet të ndihen të përfaqësuara në mënyrë autentike, jo vetëm të cituara. Kjo përfshin ftesën për zëra lokalë në studio, përmbajtje në gjuhën amtare të minoriteteve dhe prodhime që pasqyrojnë kulturën e tyre.

Kanalet e tjera të platformës së RTSH-së

RTSH 3 HD

RTSH 3 HD vazhdon linjën editoriale me programacion dedikuar bashkatdhetarëve në diasporë duke ofruar reportazhe dhe programe që lidhen me integrimin, traditat dhe aktivitetet kombëtare jashtë vendit.

RTSH Fëmijë

RTSH Fëmijë ka vijuar transmetimin e emisioneve për fëmijë si dhe duke sjelle një game të gjerë programacioni me filma e seriale të animuar për grupmoshat 2 – 10 vjeç.

RTSH Shkollë

RTSH Shkollë ka vijuar transmetimin e kurrikulës mësimore për klasat 1–12 me ritransmetime leksionesh dhe programe mbështetëse për nxënësit që ndjekin mësimin nga distance. Ky kanal e ka përmbushur misionin e tij dhe duke mos sjellë asnjë risi në programacion lind nevoja për të bërë një ristrukturim të kanalit apo bashkim me kanalin RTSH FËMIJË, duke sjellë fashëorare të përcaktuara për grupmoshat të ndryshme.

RTSH Muzikë

RTSH Muzikë sjell një shumëllojshmëri të zhanreve të ndryshme muzikore duke nisur që nga koncertet, videoklipet, operat, balet etj. Çfarë e dallon nga kanalet e tjera muzikore në tregun mediak është regjistrimi dhe transmetimi i Koncerteve të Stinës Koncertore 2023–2024 të Orkestrës Sinfonike dhe Kameratës së RTSH-së, si dhe shfaqjeve të TKOB, AKVP-së e solistëve e këngëtareve të njohur të momentit.

RTSH Film & RTSH Shqip

RTSH Film dhe RTSH Shqip janë konceptuar si dy kanale të dedikuara plotësisht kinemasë së huaj e asaj shqiptare, me zhanre të ndryshme filmi, dokumentarësh dhe serialesh si dhe bashkëprodhime dhe prodhime origjinale të RTSH-së ndër vite. Sfida e këtyre kanaleve sigurimi i të drejtave televizive të paketave të reja filmike, serile dhe dokumentarë prodhime kombëtare dhe ndërkombëtare për t'i kthyer këto kanale në dritaren e vetme të kinemasë dhe prodhimeve audioviziv.

RTSH PLUS (Dokumentar)

RTSH Plus është një kanal që në thelb të programacionit të tij ka filmën dokumentar dhe reportazhin.

Në përfundim, programacioni i RTSH-së për vitin 2024 shfaq një balancë të fortë të argëtimit, informacionit të besueshëm, kulturës kombëtare dhe temave sociale, duke ruajtur identitetin e një televizioni publik që kërkon të jetë edukues, gjithëpërfshirës dhe konkurrues në treg.

Problematikat e platformës së RTSH-së

Sfidat me të cilat përballlet kjo platforme televizive është pamjaftueshmëria e materialeve për transmetim. Platforma me 16 kanale televizive përballlet me mungesë të theksuar materialeve origjinale për të mbuluar një programacion të përditshëm 24/7. Kjo situatë sjell:

Përsëritje të shpeshtë të dokumentarëve, reportazheve, koncerteve dhe programeve në disa kanale njëkohësisht (RTSH 1, RTSH 2, RTSH 3, RTSH Plus, RTSH Shqip, RTSH Satelit, RTSH Agro dhe qendrat rajonale audiovizive, si Kukës, Korçë, Shkodër, Gjirokastrë).

Mungesë të strukturës programore me emisione të përditshme ose cikle javore. Shumica e kanaleve funksionojnë mbi baza playlistash të ndërtuara nga arkiva ose ritransmetime.

Pavarësisht përcaktimit formal të qëllimit programor për secilin kanal, në praktikë në disa kanale mungon një identitet i qartë dhe dallueshmëri vizuale dhe përmbajtësore midis tyre.

Sipas nenit 117 të ligjit nr.97/2013, RTSH dhe AMA nënshkruajnë kontratën e shërbimit të transmetimit publik, e cila mungon tashmë që prej vitit 2022, kur përfundoi kontrata e parë 5-vjeçare (2017-2022).

Arsyet kanë qenë mungesa e vazhdimësisë drejtuese në RTSH gjatë 5 viteve të fundit, si dhe nevoja për rishikimin e programeve të platformës së RTSH-së, bashkimin e disa kanaleve, apo mbylljen e disa prej tyre.

NJËSIA E EMISIONEVE TEMATIKE DHE LAJMEVE

Lajmet, emisionet dhe reportazhet në RTSH1 HD gjatë vitit 2024 pasqyruan ngjarjet më të rëndësishme nga vendi, rajoni, bota, kultura dhe sporti, duke ofruar saktësi, panashmëri dhe gjithëpërfshirje. Në rastet të vecanta, kur ngjarjet ishin të një rëndësie kombëtare, apo ndërkombëtare, transmetimet direkte informative ndërprejnë edhe rrjedhën normale të programacionit të RTSH1 (si vizita e ish-sekretarit amerikan të shtetit, samiti për Ukrainën, apo procesi i Berlinit).

Në shtator 2024, pati një ndryshim të rëndësishëm në oraret e edicioneve të lajmeve ku edicioni i orës 13:00 u zhvendos në orën 12:00 dhe u bë më dinamik dhe ai i mbrëmjes i orës 22:30 u zhvendos në orën 23:00.

Redaksia e lajmeve në RTSH ndjek parimet editoriale për të informuar publikun me objektivitet dhe profesionalizëm, duke ofruar informacione të besueshme, të balancuara e të paanshme. Mbi 50 kronika lajmesh përgatiten çdo ditë nga gazetarët e redaksisë si edhe 3 speciale/reportazhe në javë.

Viti 2024 ishte një vit shumë i rëndësishëm për Shqipërinë drejt rrugës së integritetit evropian dhe rritjes së influencës së saj në rajon e botë. Ngjarje të mëdha në aspektin politik por edhe të lidhura me reformën në drejtësi, apo edhe rritjen e turizmit, lanë gjurmë në vitin që lamë pas.

Hapja e kapitujve për integritetin e vendit në Bashkimin Evropian, samite të rëndësishme ku Shqipëria luajti rolin e organizatorit apo edhe vizita të niveleve të larta, arrestime të zyrtarëve/ish-zyrtarëve të larta nga Prokuroria kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, shenjuan vitin 2024 dhe ishin në qendër të edicioneve të lajmeve. Të gjitha këto ngjarje të rëndësishme përveçse u transmetuan drejtpërdrejt në RTSH 24, u shoqëruan me raportime direkte dhe ekskluzive nga vendi i ngjarjes në edicionet e lajmeve të RTSH 1.

Redaksia e lajmeve nga rrethet, edhe pse është një strukturë me një kryeredaktor, përveç lajmeve kryesore nga jashtë Tiranës që transmetohen në RTSH 1 dhe RTSH 24, përgjatë gjithë vitit 2024

ka përgatitur edhe 3 edicione lajmesh të dedikuara në RTSH 2. Edicionet që vijnë çdo ditë nën siglën "Shqipëria 360 gradë" sillen nga Qendrat Vendore Audiovizive (QVA) të RTSH-së dhe korrespondentët, përgatiten nga kryeredaktorja dhe 3 gazetarë të tjerë që i janë vënë në dispozicion nga redaksia e lajmeve.

Nëse do të vijojmë me edicionet e lajmeve në RTSH 2, atëherë duhet rishikuar struktura e redaksisë së rretheve, ndërsa duhet të futen në strukturë korrespondentë nga qarqet ku nuk ka QVA. Për të përmbushur detyrimet ndaj shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, redaksia e lajmeve duhet të ketë edhe korrespondentë në shtetet ku jetojnë një përqindje e lartë shqiptarësh.

Redaksia e lajmeve përgatit edicionet e minoriteteve si edhe edicionin e lajmeve me gjuhën e shenjave që transmetohen në RTSH 2. Pjesë e edicioneve të lajmeve, çdo të enjte ishte edhe raportimi nga SHBA përmes gazetarëve të Zërit të Amerikës, ndërsa falë marrëveshjes me RTK gazetarët nga Kosova raportojnë drejtpërsëdrejti në RTSH 1 dhe në RTSH 24.

Emisionet tematike trajtuan temat me interes publik në fushat e politikës, arsimit apo ekonomisë. Edhe reportazhet dhe materialet e zgjeruara speciale trajtuan përditshmërinë, historinë, kulturën dhe vecanërisht turizmin. Redaksia e reportazheve prej muajit maj nisi ciklin "Në folenë e Shqiponjave", një cikël që synoi promovimin e Shqipërisë turistike duke treguar vende të njohura dhe të panjohura për turistët dhe vendasit.

Redaksia e lajmeve gjatë muajve korrik- gusht 2024 zhvilloi një cikël kronikash nën siglën "Një kafe me RTSH" me intervista dhe pyetësor me qytetarët në të gjithë vendin për të mësuar prej tyre se çfarë kërkonin të ndiqnin në rrjetin e RTSH. (kjo fushatë ishte pjesë e memorandumit të bashkëpunimit me radion suedeze). Sugjerimet dhe propozimet e tyre po gjejnë pasqyrim në edicionet e lajmeve por edhe programacionin e Njësisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve.

Gjatë vitit 2024, gazetarët e lajmeve u bënë pjesë edhe e disa trajnime ndërkombëtare nga EBU, Radio Suedeze, Deutsche Welle, TRT, apo Goethe, disa prej tyre zhvilluan vizita pranë këtyre institucioneve mediatike. Gjatë vitit të shkuar, Njësia e Lajmeve fitoi edhe një projekt të financuar (60 mijë euro) nga Goethe Institute/BE për pajisjen e gazetarëve me MO-JO dhe pajisje të tjera për transmetime të drejtpërdrejta.

RTSH 24

Gjatë vitit 2024, në RTSH 24 ka një ndarje të aktivitetit në dy pjesë, para dhe pas nisjes së transmetimeve në mjediset/studion e re të kanalit. Nga 1 maji 2024, RTSH 24 funksionon i pavarur në aspektin teknik dhe televiziv, por pa staf të mirëfilltë prodhues në strukturë. RTSH24 transmeton Live nga ora 07:00 e mëngjesit deri në 24:00. Për të përballuar punën, nga njësia e Lajmeve janë vendosur në dispozicion të RTSH24 disa gazetarë, moderatorë apo redaktorë që nuk kryejnë funksionet e tyre sipas kontratës së punës. Nisur nga natyra 24 orë lajme, ky kanal ka nevojë për një strukturë të pavarur të burimeve njerëzore, prodhuese dhe krijuese.

RTSH Sport

Gjatë 2024, RTSH Sport solli ekskluzivitete dhe transmetime të drejtpërdrejta të disa prej ngjarjeve kryesore sportive ndërkombëtare, si Champions League (deri në maj 2024), Olimpiada Paris 2024 (ku morën medalje edhe sportistët shqiptarë), Euroliga e Basketbollit, kampionati Botëror i Mundjes (për herë të parë në Shqipëri) etj. Ekskluzivitete pati edhe nga sporti vendas, si kampionati shqiptar i Futbollit që u rikthye në ekranit e RTSH në gusht 2024 për 3 sezone (1.4 mln euro sezoni), kampionatet e basketbollit, volejbollit, mundjes etj. Prej shtatorit 2024, RTSH Sport nuk gëzon më ekskluzivitetin e Champions League, por ka të drejtat e Europa/Conference League.

Marrja e të drejtave të Kampionatit Shqiptar të Futbollit ishte një lajm shumë i mirë për RTSH, por edhe një sfidë e madhe, pasi shtoi numrin e transmetimeve të ndeshjeve direkte, por ndikoi edhe në rritjen e audiencës që kishte kërkuar prej vitesh që ky kampionat të transmetohej në RTSH për shkak edhe të shtrirjes së sinjalit në të gjithë vendin. Kampionati analizohet në dy emisionet sportive: Supergol dhe Rubrika Sportive. Ndërkohë mungesa e komentatorëve në strukturë është një shqetësim permanent, pasi aktualisht ky funksion kryhet nga gazetarët e redaksisë. Të gjithë kampionatet europiane të futbollit edhe pse nuk transmetohen ekskluzivisht në RTSH Sport, analizohen përmes emisionit Eurogol.

Stafi i RTSH Sport organizon dhe transmeton emisionin "Nga njëra ndeshje në tjetrën" në Radio Tirana që transmeton emocionet e golave në Kategorinë Superiore dhe të Parë të futbollit. Shqetësimi që ngrihet nga kjo redaksi janë kategoritë e ndryshme mes gazetarëve por edhe rregullimi i strukturës së kanalit që duhet të ketë të përfshirë edhe komentatorë.

RTSH Kuvend

Përgjatë vitit 2024, RTSH Kuvend ka transmetuar drejtpërsëdrejt 1289 seanca të komisioneve parlamentare dhe 49 seanca parlamentare, si edhe 11 aktivitete të tjera të kryetares të Kuvendit. Po ashtu, gjatë vitit 2024 janë transmetuar 15 episode nga një cikël emisionesh i titulluar "Dialog për Konsensus" me intervista dhe analiza nga parlamentarët për diskutimin e ligjeve me impakt për grupet e interesit. Për shkak se struktura e kanalit ka vetëm një redaktor përgjegjës, një gazetarë nga redaksia e lajmeve është vënë në dispozicion të këtij kanali për të ndihmuar në mbarëvajtjen e punës. Mungesa e një strukture burimore e bën të pamundur realizimin e rekomandimeve që vijnë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe vetë Parlamenti për pasurimin e programacionit të këtij kanali.

Redaksia e Lajmeve në Radio Tirana ka ndjekur zhvillimet duke qenë në të njëjtën kohë me redaksinë e lajmeve në RTSH 1. Volumi i punës dhe angazhimi i stafit kanë qenë edhe më intensive që prej shtatorit 2023, ku edicionet dhe flashet informative vijnë në valët e radios çdo një orë përgjatë gjithë ditës. Redaksia e lajmeve të radios kërkon njehësimin e pagave me gazetarët e televizionit.

Redaksia e Gjuhëve të Huaja në Radio Tirana Internacional ka përgatitur gjatë vitit 2024, programe speciale radiofonike, duke iu ofruar dëgjuesve informacion të pasur historik, kulturor,

promocional dhe festiv. Në faqen e web-it dhe facebook në kohë reale janë postuar çdo ditë 100-140 artikuj. Që prej 1 majit 2024 seksioni i anglishtes është i angazhuar edhe në përkthimin e titrave të RTSH 24. Po ashtu, kjo redaksi është e angazhuar edhe në përkthimin e dokumenteve zyrtare të RTSH-së, si dhe në emisione radiofonike dhe televizive. Problematike në këtë redaksi janë kategoritë e ndryshme mes punonjësve.

NJËSIA TEKNIKE

Njësia Teknike e RTSH-së ka qenë gjatë gjithë vitit 2024 në shërbim të njësive të tjera prodhuese, duke garantuar prodhimin dhe shpërndarjen e sinjaleve televizive dhe radiofonike në të gjitha platformat përkatëse. Si pjesë e një institucioni që funksionon 24 orë në ditë, Njësia Teknike ka pasur një impenjim të vazhdueshëm në sigurimin e funksionalitetit pa ndërprerje të transmetimit.

Lloji i shërbimeve që ofron dhe infrastruktura që shfrytëzon Njësia Teknike konsiderohen në shumicën e tyre si sisteme të rëndësishme të veçantë, jo vetëm për institucionin e RTSH, por edhe për institucione të tjera shtetërore dhe private të cilat mbështesin pjesë të shërbimeve të veta në infrastrukturën e RTSH-së, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontratat që institucioni ka në zbatim. Këtu mund të përmenden marrëveshjet me ministri të ndryshme, kontrata me operatorët mobile dhe kontrata me operatore transmetues ndërkombëtarë siç është ajo me BBC.

- Transmetimi dhe mbulimi me shërbim

Gjatë vitit 2024, Njësia Teknike ka punuar për të garantuar transmetimin 24/7 në platformat DVB-T2, DVB-S2, FM dhe streaming online, për një numër të gjerë kanalesh kombëtare dhe lokale. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zbatimit të kontratës së mirëmbajtjes, duke siguruar mbulim transmetimi për mbi 90% të popullsisë së Republikës së Shqipërisë. Disponueshmëria e rrjetit transmetues arriti nivelin 99.92%, një rritje prej 0.01% krahasuar me vitin 2023.

- Përmbushja e kërkesave teknike

Njësia Teknike ka përmbushur me sukses të gjitha kërkesat teknike për prodhimin dhe transmetimin e produkteve televizive dhe radiofonike, bazuar në infrastrukturën ekzistuese në dispozicion.

- Projekte të realizuara

- RTSH 24: Është ngritur infrastruktura teknike e pavarur për funksionimin 24 orë në 7 ditë të javës të kanalit RTSH 24.
- Lidhje direkte: Janë realizuar me sukses lidhje direkte nga çdo vend i kërkuar nga departamentet e prodhimit.
- Mbështetje për evente madhore: Janë realizuar me sukses ngjarje si Kampionati Europian i Futbollit, Kampionati Shqiptar dhe Festivali i Këngës.

○ Transmetimi parlamentar: Është vijuar transmetimi live i seancave parlamentare dhe punimeve të komisioneve të Kuvendit.

- Mirëmbajtje dhe optimizim teknik

Është kryer një punë e vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe optimizimin e sistemeve teknike ekzistuese. Këto detyra janë realizuar me përkushtim të lartë profesional, edhe në kushte të vështira logjistike, mungesë stafi dhe mjeteve teknike.

- Problematikat e hasura

Gjatë vitit 2024 janë evidentuar këto problematika:

- Mungesa e stafit teknik të specializuar,
- Vonesa në realizimin e investimeve të domosdoshme të cilat kanë ardhur si pasojë e mosrealizimit të procedurave të prokurimit, të cilat kanë penguar realizimin e procedurave të mirëmbajtjes për disa sisteme ku më kryesorja është mirëmbajtja e rrjetit DVB-T2,
- Amortizimi i pajisjeve për shkak të mungesës në Investime të vazhdueshme në teknologji
- Ndryshimi i shpeshtë strukturave prodhuese dhe krijuese ka shkaktuar paqartësi gjithashtu në drejtimin e investimeve.

• Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit ka vijuar veprimtarinë e saj me përqendrim në garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemeve të informacionit, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe rritjen e standardeve të sigurisë digjitale. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me njësitë e tjera të RTSH-së, janë realizuar ndërhyrje të rëndësishme në drejtim të administrimit të rrjeteve, serverëve dhe mbështetjes teknike për të gjitha strukturat.

Optimizimi i Infrastrukturës së IT-së

Është realizuar riorganizimi i rrjeteve lokale në disa njësi kyçe të institucionit, duke përfshirë RTSH 24 dhe Web-it, me synimin për të përmirësuar efikasitetin e qarkullimit të informacionit dhe performancën e shërbimeve të brendshme.

Janë ndërmarrë masa të vazhdueshme për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve ekzistuese, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të operacioneve ditore.

Administrimi i Mail Server-it të RTSH-së

Është vijuar me administrimin e rregullt të shërbimit të postës elektronike të institucionit, duke përfshirë ruajtjen e integritetit dhe disponueshmërisë së sistemit.

Në kuadër të masave të sigurisë, janë zbatuar politika filtrimi dhe monitorimi të avancuar që kanë rezultuar efektive në identifikimin dhe bllokimin e rreth **60 email-eve të dyshimta** me përmbajtje të dëmshme ose virus.

Arkivimi dhe Ruajtja e të Dhënave

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arkivit, është vënë në funksion përdorimi i teknologjisë **LTO për arkivimin offline**, si pjesë e strategjisë për ruajtjen afatgjatë dhe të sigurt të materialeve të prodhuara nga RTSH.

Shërbimi i Brendshëm Teknik dhe Mbështetja për Strukturat

Është ofruar asistencë teknike e vazhdueshme për të gjitha strukturat e RTSH-së, përfshirë konfigurimin e pajisjeve të reja dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të stacioneve të punës.

Është organizuar dhe menaxhuar me eficiencë funksioni i Help Desk-it, duke garantuar zgjidhje të shpejtë të problematikave dhe rikthimin në punë të shpejtë të sistemeve të prekur.

Konfigurimi i Sistemit të Televotimit për Festivalin e Këngës

Është realizuar konfigurimi dhe asistencë teknike për funksionimin e sistemit të televotimit në Festivalin e Këngës, duke garantuar besueshmëri dhe integritet të procesit të votimit në kohë reale.

Sfidat e hasura

Prodhimi i vazhdueshëm multimedial i RTSH-së kërkon në mënyrë konstante **kapacitete të mëdha ruajtjeje**, çka paraqet nevojë të përhershme për zgjerim të infrastrukturës së storage-it.

Vonesat në zëvendësimin e pajisjeve të vjetra dhe të amortizuara kanë ndikuar në ritmin e disa ndërhyrjeve, duke kërkuar monitorim dhe ndërhyrje të shpeshta nga stafi teknik.

Përmirësim në fushën e sigurisë

Aktualisht, infrastruktura e sigurisë së rrjetit bazohet në një **firewall të gjeneratës së vjetër**, i cili nuk përmbush më standardet moderne të mbrojtjes që kërkohen për një institucion të përmasave të RTSH-së.

Nevojitet investim në një firewall të ri të gjeneratës së fundit, i cili do të ofrojë:

- Mbrojtje të shtresuar ndaj sulmeve dhe kërcënimeve kibernetike;
- Kontroll të avancuar të trafikut të rrjetit sipas politikave të përcaktuara;
- Integrim të platformave të sigurisë për një arkitekturë të centralizuar dhe të menaxhueshme.

Stafi i Drejtorisë së IT-së ka qenë plotësisht i angazhuar në përmbushjen e detyrave funksionale gjatë vitit, duke ofruar reagim të shpejtë dhe profesional në çdo situatë teknike.

Për më tepër, evidentohet nevoja për **shtim të kapaciteteve njerëzore me profil të dedikuar në sigurinë kibernetike**, duke qenë se sfidat në këtë fushë janë gjithnjë e më të kompleksuara dhe kërkojnë përgatitje të specializuar.

Të vijojë konsolidimi dhe modernizimi i infrastrukturës teknologjike me fokus në qëndrueshmëri, siguri dhe performancë.

Të realizohet në kohë implementimi i një **sistemi të ri firewall**, si një element kyç në arkitekturën e sigurisë.

Të intensifikohet puna për krijimin e një strukture të dedikuar të sigurisë kibernetike brenda Drejtorisë së IT-së.

DREJTORIA EKONOMIKE


Struktura e të ardhurave të RTSH gjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2024

A. Struktura e të ardhurave të realizuara:

Në mënyrë të detajuar burimet nëpërmjet të cilave RTSH ka realizuar të ardhurat gjatë kësaj periudhe janë:

BURIMI	Të ardhurat në lekë
Financimi nga Buxheti i Shtetit 30.1%	673,497,508
Tarifa mbi Aparatin Marrës radio televiziv 59.3%	1,326,126,121
Kontratat e shfrytëzimit të infrastrukturës së transmetimit 4.8%	107,981,071
Reklamat, njoftimet kronikat etj 4.1%	92,073,722
Të ardhura të tjera, youtube, web, shitje bileta, mat.arkivore, qira, etj. 1.7%	37,221,123
TOTALI	2,236,899,545

Në një paraqitje grafike, të ardhurat sipas burimeve të financimit janë realizuar në raportet e mëposhtme:



B. Realizimi i të ardhurave në krahasim me planifikimin e periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2024:

Në lekë

Nr	Emërtimi	Planifikimi i Vitit 2024	Realizimi Janar - Dhjetor 2024	% e realizimit
I.	Financimi nga buxheti	693,000,000	673,497,508	97.2%
a	Bashkatdhetarët&Sateliti	279,000,000	279,000,000	100.0%
b	Projekte Filmike&Artistike	91,000,000	91,000,000	100.0%
c	Orkestra Simfonike RTSH	100,000,000	100,000,000	100.0%
d	Projekte Tekn.Teknologji te reja SLA	200,000,000	200,000,000	100.0%
e	Investime	23,000,000	3,497,508	15.2%
II.	Të ardhura nga tarifa aparatit TV.	1,736,063,225	1,326,126,121	76.4%
III.	Të ardhura te institucionit	331,050,000	237,275,916	71.7%
a	Sherbim ambjente transmetuese, tr. fm	130,000,000	107,981,071	83.1%
b	Reklama, njoftime etj.	146,350,000	92,073,722	62.9%
c	Të ardhura të tjera	54,700,000	37,221,123	68.0%
TOTALI		2,760,113,225	2,236,899,545	81.0%

Të ardhurat janë realizuar në masën 81% të planifikimit, për periudhën 12 mujore Janar – Dhjetor 2024.

Në mënyrë analitike realizimi i të ardhurave paraqitet:

I - Të ardhurat nga buxheti gjatë vitit 2024 janë realizuar në nivelin 97.2%.

Përgjatë vitit 2024, përveç atij të miratuar në fillim të vitit, RTSH ka pasur shtesa dhe pakësime në financimin nga Buxheti i shtetit. Paraqitja e financimit, shtesat, pakësimet dhe realizimi i tyre është si më poshtë:

Emërtimi	Financimi 2024, sipas Ligjit 97/2023	Shtese buxhetore sipas Aktit Normativ nr.3 date 28.08.2024 je ME	Pakesim buxhetor sipas Aktit Normativ nr.5 date 19.12.2024 je ME	Gjithsej Financim buxhetor 2024	Realizimi Janar - Dhjetor 2024	Të realizuar 31.12.2024
Financimi nga buxheti	690,000,000	80,000,000	(77,000,000)	693,000,000	673,497,508	19,502,492
Bashkëpunimet&Sateliti	240,000,000	30,000,000		270,000,000	279,000,000	-
Projekte Filmike&Artistike	68,000,000	23,000,000		91,000,000	91,000,000	-
Orkestra Simfonike RTSH	82,000,000	18,000,000		100,000,000	100,000,000	-
Projekte Tekn. Teknologji te reja SLA	210,000,000			210,000,000	200,000,000	-
Investime	100,000,000		(77,000,000)	23,000,000	3,497,508	19,502,492

a) Në Programin e parë Bashkatdhetarët dhe Shërbimi Satelitor në masën 100%.

b) Në Programin e dytë projekte Filmike & Artistike në masën 100%.

c) Në Programin e tretë Orkestra Simfonike e RTSH-së në masën 100%.

d) Në Programin e katërt të Projekteve Teknike për futjen e Teknologjive të reja. Shpenzimeve për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit etj në masën 100%.

e) Në programin e pestë të Investimeve Kapitale në masën 15.2%, ose në vlerë 3,497,508 lekë nga planifikimi pas shtesave e pakësimeve prej 23 milion lekë.

Investimet kapitale nga Buxheti i shtetit në këtë zë ishin parashikuar për projektin e Rikonstruksionit të Godinës së Ateliesë së Re dhe blerjen e pajisjeve teknike për Atelienë e Re. Por gjatë vitit 2024, kryerja e këtij investimi në vlerat e parashikuara rezultoi e pamundur.

Me shkresën Nr.2824Prot., datë 08.10.2024, RTSH ka vënë në dijeni Ministrinë e Financave për problematika në lidhje me zbatimin e procedurave për kryerjen e investimit të sipërpërmendur. Në vijim me aktin Normativ Nr.5, datë 19.12.2024, Buxheti i miratuar i RTSH-së për zërin investime, përcakuar në projektin e Ateliesë së Re, u pakësua me 77,000,000 lekë, duke lënë në këtë zë vetëm vlerën e kontratës së sipërmarrjes për Rikonstruksionin e Godinës së Ateliesë së Re.

Duke qenë se lidhja e kontratës u mundësua në Tetor 2024 dhe punimet për zbatimin e kësaj kontrate filluan mbas marrjes së lejes për fillimin e punimeve, me një afat 4 mujor. RTSH ka marrë para nga Dega e Thesarit Tiranë, ndryshimin e obligimit të saj në vlerën totale për vitin 2024 prej 12,000,000 lekë. Sidoqoftë nga ana e Operatorit Ekonomik që kryen këto punime deri në 31 Dhjetor 2024 u mundësuan punime në vlerën totale prej 3,497,508 lekë.

II. E ardhura nga tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv në masën 76.4%.

Tarifa e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv është realizuar në masën 76.4% në krahasim me planin e periudhës, ose me një mosrealizim në një vlerë për afro 410 milionë lekë. Mosrealizimi në këtë zë vjen kryesisht si rezultat i planifikimeve që u bënë në buxhet në fillim të

vitit, bazuar në kërkesat e vazhdueshme për një rritje të tarifës nga ajo që është aktualisht, uljen e komisionit të agjentit tatimor (OSHEE), nga 10% në 2%, si dhe faturimi i shërbimit për përdorimin e aparateve televizive për përdoruesit jo-familjarë bazuar në numrin e aparateve/dhomave. Por gjatë vitit 2024, përsëri këto ndryshime nuk u mundësuan.

III. Të ardhurat e tjera të institucionit janë realizuar në masën 71.7%, nga këto :

a. Të ardhurat nga shërbimi në ambjentet transmetuese të RTSH dhe transmetime FM janë realizuar me 83.1%.

Të ardhurat nga shërbimi në stacionet e RTSH-së dhe transmetimi në FM megjithëse qenë parashikuar në një vlerë prej 5 milion lekë më shumë se një vit më parë nuk arritën të realizohen as në nivele të njëjta. Mos realizimi në këtë zë është në shumën rreth 22 milion lekë.

b. Të ardhurat nga reklamat, njoftimet etj., janë realizuar në masën 62.9%,

Planifikimi është bërë mbi bazën e parashikimeve të pritshme nga Drejtoria e Shitjes dhe Promocionit, por gjatë vitit 2024 realizimi nuk qëndron në nivelet e parashikuara nga kjo Drejtori.

Në mënyrë analitike të ardhurat e realizuara paraqiten:

- Drejtoria e Shitjes dhe Promocionit në vlerën 85,629,814 lekë
- Qendra Vendore Audiovizive Gjirokastrë në vlerën 1,685,913 lekë
- Qendra Vendore Audiovizive Shkodër në vlerën 45,130 lekë
- Qendra vendore Audiovizive Korçë në vlerën 4,712,865 lekë

c. Në zërin e të ardhurave të tjera janë realizuar të ardhurat e parashikuara, në nivelin 68%, ose në vlerë prej 37.2 milion lekë. Në këtë zë janë përfshirë të ardhurat nga:

- ✚ Qira tokash, ndërtesa, bankomatesh etj për 3,773,627 lekë
- ✚ Të ardhura nga platforma Youtube 12,137,631 lekë
- ✚ Shitje biletash për 13,492,340 lekë
- ✚ Të tjera të ndryshme dhe shitja materialeve arkivore për 7,817,524 lekë.

Mosrealizimi në zërin e të ardhurave të tjera vjen kryesisht nga mos shpërndarja nga kompania Eutelsat gjatë vitit 2024 e të ardhurave nga dividendi si pjesëmarrje e RTSH në kapitalin aksioner të saj. Të ardhura këto që për vitin 2024, duke qenë se edhe një vit më parë nuk ishin shpërndarë ishin parashikuar në shumën 25 milion lekë.

C. Krahasimi i të ardhurave të së njëjtës periudhë gjatë tre viteve të fundit.

Nr	Emertimi	Realizimi	Realizimi	Realizimi
		Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
I.	Financimi nga buxheti	567,600,000	668,000,000	673,497,508
	Bashkatdhetarët&Sateliti	240,000,000	240,000,000	279,000,000
	Projekte filmike dhe artistike	67,600,000	68,000,000	91,000,000
	Orkestra Simfonike RTSH	62,400,000	90,000,000	100,000,000
	Projekte Tekn.Teknologji te reja SLA	197,600,000	270,000,000	200,000,000
	Investime			3,497,508
II.	Të ardhura nga tarifa aparatit TV.	1,282,468,661	1,282,966,568	1,326,126,121
III.	Të ardhura të institucionit	379,381,722	212,330,957	237,275,916
	Shërbim ambiente transmetuese, tr. fm	118,249,906	123,214,853	107,981,071
	Reklama, moftime etj.	217,056,594	71,994,847	92,073,722
	Të ardhura të tjera	44,075,222	17,121,257	37,221,123
TOTALI		2,229,450,383	2,163,297,525	2,236,899,545

*Shënim: Në zero Projekta Teknike, teknologjike, gjatë vitit, në muajt janar 2024 është lehtëqur shësa buxhetore e muajt dhjetor 2023, prej 50 milion.

Sic shikohet edhe nga tabela e mësipërme në krahasim me të njëjtën periudhë në dy vitet e fundit. (2023 dhe 2024) **Financimi nga buxheti i shtetit** ka qenë me një rritje prej më se 100 milion lekë nga viti 2022, kryesisht si pasojë e rritjes në dy vitet e fundit në programin e Orkestrës Simfonike RTSH, rritjes në vitin 2024 në programin e Bashkatdhetarëve dhe Satelitit dhe programin e Projekteve Filmike e Artistike.

Gjatë vitit 2024, financimi në Programin e Projekteve Teknike për futjen e Teknologjive të reja ishte 70 milion lekë më pak se në vitin paraardhës, Program ky që mbulon pjesërisht detyrimin kontraktor për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit.

Në total, financimi për shpenzimet operative sipas programeve të mësipërme gjatë vitit 2024, ka qenë në vlerën 2 milionë lekë më shumë se viti 2023. Nëse në vitet 2022 dhe 2023, nuk ka pasur financim për investime kapitale, gjatë vitit 2024, ato ishin mundësuar në vlerën 23 milion, nga të cilat janë realizuar në afro 3.5 milion lekë.

Të ardhurat nga tarifa e aparateve tv ka qenë pothuajse e njëjtë gjatë dy viteve paraardhës, ndërsa në vitin 2024, pati një rritje prej më shumë se 43 milion lekë.

Të ardhurat e institucionit pësuan një ulje gjatë vitit 2023, ulje që konsiston kryesisht në rënie nga të ardhurat e reklamave dhe marketingut, ku vlen të theksohet se në dy vitet e fundit nuk ka pasur evente sportive që rrisin ndjeshëm në periudhën përkatëse të ardhurat nga reklamat.

Megjithatë gjatë vitit 2024 të ardhurat nga reklamat dhe marketingu patën një rritje me 20 milion lekë krahasuar me vitin 2023, ato ishin shumë më të ulta se vitit 2022.

Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese paraqiten me të ulta gjatë vitit 2024 me një rënie prej mëse 10 milion krahasuar me vitin 2022 dhe më shumë se 15 milion lekë krahasuar

me vitin 2023. Kjo kryesisht si pasojë e largimit të subjekteve nga allotmentet e infrastrukturës digjitale.

Të ardhurat e tjera të vetë RTSH, ndonëse në krahasim me vitin 2022 janë më të ulta, gjatë vitit 2024 u rritën me rreth 20 milion lekë krahasuar me vitin 2023.

Theksojmë se në vitin 2022 janë arkëtuar 25.6 milion lekë nga kompania Eutelsat, të ardhurat nga dividendi si pjesëmarrje e RTSH-së në kapitalin aksioner të saj për vitet 2021, gjë që nuk u mundësua gjatë viteve 2023 dhe 2024.

Detyrimet e të tretëve ndaj RTSH

Në mënyrë të përbledhur, detyrimet e të tretëve ndaj RTSH, kërkesat për arkëtim dhe ecuria e tyre gjatë 4 tremujorëve të fundit paraqiten si vijon:

Detyrime nga te tjere	Periudha:			
	31.03.2024	30.06.2024	30.09.2024	31.12.2024
Te drejta te pritshme te arketohen	141,779,435	161,052,890	167,693,639	195,855,253
Te drejta nga kontrata shkembimi	46,632,248	33,591,013	33,477,230	27,946,218
Te drejta ne proces gjyqesor te pritshme	7,039,712	7,039,712	7,039,712	7,039,712
Detyrime nga te tjere pa shprese arketimi	41,758,291	41,758,291	41,758,291	41,758,291
Totali nga kliente	237,209,686	243,441,906	249,968,872	272,599,474
Llogari provigjione	12,941,248	12,941,248	12,941,248	12,941,248
SHUMA KUIENTE DHE PROVIGJIONE	250,150,934	256,383,154	262,910,120	285,540,722

Ndërsa me të njëjtën periudhë të një viti më parë, detyrimet e të tretëve ndaj RTSH, krahasimisht janë:

Detyrime nga te tjere	Periudha:		
	31.12.2023	31.12.2024	Ndryshimi
Te drejta nga te ardhura teknike te pritshme te arketohen	94,341,416	143,808,983	49,467,567
Te drejta nga te ardhura marketing te pritshme te arketohen	47,547,779	52,046,270	4,498,491
Te drejta nga kontrata shkembimi	48,464,168	27,946,218	(20,517,950)
Te drejta ne proces gjyqesor te pritshme	7,039,712	7,039,712	-
Detyrime nga te tjere pa shprese arketimi	41,758,291	41,758,291	-
Totali nga kliente	239,151,366	272,599,474	33,448,108
Llogari provigjione	12,941,248	12,941,248	-
SHUMA KUIENTE DHE PROVIGJIONE	252,092,614	285,540,722	33,448,108

Siç vihet re, gjatë vitit 2024 ka një rritje në të drejtat e pritshme për t'u arkëtuar, kryesisht nga klientët e infrastrukturës transmetuese me një rritje prej rreth 49.5 milion, nga klientët e reklamave e publicitetit me rreth 4.5 milion lekë. Ndërkohë ka ulje në të drejtat nga kontratat me shkëmbim në rreth 20.5 milion lekë.


Struktura e shpenzimeve gjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2024

Në vijim të ndryshimeve të financimit buxhetor, siç sqaruar edhe në trajtimin e të ardhurave 2024, shpenzimet pas ndryshimeve në planifikim paraqiten si vijon:

Nr	Emertimi	Planifikim Viti 2024	Realizimi Viti 2024	Realizimi ne %
1	Paga,shpërblime ,sig.shoqëror	1,185,472,512	1,183,433,028	99.8%
2	Materiale,lende djegese	66,000,000	48,127,235	72.9%
3	Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav.	443,496,000	371,718,165	83.8%
4	Organizma Nderkombetar	62,800,000	55,184,853	87.9%
5	Shërbime nga të tretë	257,180,000	293,406,115	114.1%
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	32,500,000	32,475,364	99.9%
7	Shpenzime të tjera operative	65,440,000	62,530,374	95.6%
8	Mirembajtje rrjeti digjitalizimit	241,924,713	221,476,816	91.5%
9	Investime	80,500,000	3,497,508	4.3%
	Totali pa kestin e kredise	2,435,313,225	2,271,849,458	93.3%
10	Shpenz.këste e interesa kredie	324,800,000		
	TOTALI	2,760,113,225	2,271,849,458	82.3%

Shpenzimet e RTSH-së gjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor janë realizuar në nivelin 93.3%, pa përfshirë detyrimin për kredinë që është likujduar nga Ministria e Financave (kësti i parë në muajin Mars 2024 në vlerën 1,409,117 Euro dhe kësti i dytë në muajin Shtator 2024 në vlerën 1,370,479 Euro).

Në mënyrë grafike pesha e shpenzimeve të ndryshme paraqitet si vijon:



Zëri Paga, sigurime shoqërore e shpërblime është realizuar 99.88% dhe përbën 52.1% të shpenzimeve të RTSH-së gjatë periudhës.

Numri mesatar mujor i punonjësve gjatë vitit 2024 është 1007 punonjës. Në fund të vitit ky numër është 1035 punonjës, nga 994 në fund të vitit 2023.

Paga mesatare e punonjësve gjatë vitit 2024 llogaritet 77,900 lekë. Ndërkohë që paga mesatare në janar të vitit 2024 ishte 75,600 lekë, paga mesatare në muajin dhjetor 2024 ishte 81,200 lekë.

Pagat, përfshirë vlerat e turneve të dyta e të treta të punonjësve, mbikoha, shpërblimet e ndihmat janë në vlerën 1.019.704.482 lekë. Nga këto vlera e kontratave të shërbimit gjatë vitit 2024 është në shumën 10.641.722 lekë. Sigurimet shoqërore e ato shëndetësore në shumën 163.728.546 lekë.

Zëri Materiale në total për 48.127.235 lekë, përfshin shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore teknike, materiale ndihmëse, në shumën 28.451.678 lekë dhe lëndë djegëse (karburant), realizuar në vlerë 19.675.557 lekë. Niveli i shpenzimeve për materiale e lëndë djegëse është 72.9% në krahasim me planifikimin e vitit 2024.

Zëri i projekteve Filmike dhe Artistike, blerje të drejtave televizive & Fondi i prodhimit të pavarur, në total ishte 371.718.165 lekë dhe është realizuar në masën 83.8% përfshin:

- a) Të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit evente sportive është realizuar në vlerën 68.298.741 lekë.
- b) Shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, filma e dokumentare, në vlerën 5.259.500 lekë.
- c) Projekte filmike e Artistike, dhe shpenzime për to, si edhe marrje pajisjesh me qira për projekte, realizuar në vlerën 298.159.924 lekë.
- d) Fondi i prodhimit të pavarur planifikuar në vlerën 12.000.000 lekë nuk është shpenzuar gjatë vitit 2024.

Zëri i Organizmave Ndërkombëtare përfshin të gjitha shpenzimet që RTSH kryen ndaj organizmave ndërkombëtare realizuar në masën 87.9%, si: Eutelsat e Ses Astra për shërbimin satelitor në vlerën 20.092.876 lekë, si edhe kuota e pjesëmarrjes paguar për EBU, por edhe pagesat për AFP, Kosova Press, etj për 35.091.977 lekë.

Zëri i Shërbimeve nga të tretë përfshin shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretët për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH-së, si shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzimet telefonike, shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH, qira të ambienteve, mirëmbajtje si dhe shpenzime të tjera.

Në këtë zë janë përfshirë edhe shpenzimet për vendime gjyqësore, shpenzime këto që kanë qenë në nivele shumë më të larta se parashikimi vjetor i tyre.

Realizimi i këtij zëri është në nivelin 114% dhe në mënyrë analitike paraqitet:

- Shpenzimet për energji elektrike 112,381,888 lekë, ujë në vlerën 3,425,786 lekë.

- Shërbimi i ruajtjes fizike në vlerën 31,609,612 lekë.
- Shpenzimet për qira për pronarët e truallit ku janë ndërtuar kullat e transmetimit gjatë procesit të digjitalizimit, kontrata për përdorimin e linjave elektrike për stacionet Dvb-t2, etj, prej 24,360,846 lekë.
- Telefoni e shpenzime postare në vlerën 1,848,933 lekë.
- Shpenzimet e internetit dhe fibrave optike në vlerën 16,436,732 lekë.
- Siguracione në vlerën 17,550,739 lekë. Nga të cilat sigurimi i jetës dhe aksidenteve për punonjësit në shumën 15,432,200 lekë, dhe pjesa tjetër siguracionet e mjeteve të RTSH dhe sigurim shëndeti në udhëtim.
- Pagesa e frekuencave në AKEP, dhe lipensa të ngjashme në vlerën 14,145,859 lekë.
- Shpenzime për mirëmbajtje të përgjithshme në vlerën 10,108,912 lekë.
- Shpenzime të ndryshme e komisione në vlerën 4,141,889 lekë.
- *Shpenzimet gjyqësore në vlerën 57,394,919 lekë, ku është përfshirë kryesisht një detyrim i lindur si pasojë e një vendimi gjyqësor, i cili u zbatua me anë të vendosjeve të sekuestrove ekzekutive në muajt Korrik-Gusht 2024, në dëm të RTSH me palë përfituese një ish punonjës të RTSH, aksidentuar vite më parë në punë. Edhe pjesa tjetër e shpenzimeve gjyqësore janë vendime me ekzekutim të përkohshëm (mbas shkallës së parë të gjykimit) për punonjës të larguar nga puna kryesisht në fund të vitit 2023 dhe fillim të vitit 2024.*

Përveç se në tejkalimin e shpenzimeve për këtë zë, këto shpenzime kanë ndikuar ndjeshëm edhe në aftësinë paguese të RTSH.

Zëri i shpenzimeve Udhëtime e dieta është realizuar pothuajse në masën 100%, dhe në vlerë prej 32,475,364 lekë.

- Rreth 27 % e përbëjnë shpenzimet në Njësinë Tematike dhe të Lajmeve, për vetë natyrën e kësaj Njësie.
- 9% e shpenzimeve janë në Njësinë Teknike për regjistrimin dhe transmetimin e aktiviteteve sportive, politike e artistike, si edhe për riparimet e defektet që ndodhin në stacionet rtv e furnizimin me karburant të gjeneratorëve në stacionet radiotelevizive.
- Rreth 56 % e shpenzimeve janë në Drejtorinë e Përgjithshme, përfshirë Departamentin e Prodhimit, që zë një peshë të konsiderueshme në këto shpenzime.
- 8 % në Njësinë e Programeve, Qendrat vendore Audiovizive për realizimin e programeve.

Zëri i shpenzimeve të tjera Operative është realizuar në nivelin 95.6%.

Në këtë zë të planifikuar për 65,440,000 lekë janë përfshirë shpenzimet për:

- Honorare në shumën 59,932,383 lekë

- Taksa e tatime, në vlerën 1,580,126 lekë
- Shpenzime për pritje e përcjellje në shumën 1,017,865 lekë.

Zëri i shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit të digjitalizimit (mirembajtje e sistemit të transmetimit DVB-T2, Playout, Head-end satelitor etj.), është realizuar në masën 91.5%.

Për mirëmbajtjen e rrjetit të digjitalizimit janë shpenzuar 221,476,816 lekë. Ndryshimi mes planifikimit dhe realizimit të këtij zëri vjen si rrjedhojë e ndryshimit në rënie të kursit të monedhës në të cilën ai parashikohet dhe paguhet.

Zëri i shpenzimeve për investime, parashikuar në fillim vit në vlerën 157.5 milion lekë, do të konsistonte kryesisht në projektin e rinovimit të Ateliesë së Re (për të cilën do të financoheshin 100 milion lekë nga Buxheti i shtetit), rinovim ambientesh, investime teknike, etj. Në këtë zë pati pakësim në financimin buxhetor prej 77 milion lekë dhe investimet e tjera kryesisht të parashikuara për shkak të gjendjes financiare të RTSH nuk u realizuan. Realizimi i vetëm në këtë zë i përket projektit të ateliesë dhe është në vlerën 3,497,508 lekë.

Zëri i shpenzimeve të kësteve dhe interesave të kredisë nuk është realizuar si rezultat i mungesës së të ardhurave që shkakton pamundësi financiare të RTSH-së për përballimin e këtij shpenzimi aktualisht. Këstet mujore janë paguar nga Ministria e Financave dhe përmendim që me pagesën e këstit të fundit në Shtator 2024, detyrimi ndaj Deutsche Bank për këtë kredi është mbyllur.

Krahasimi i Shpenzimeve të RTSH të viteve 2022, 2023 dhe 2024.

Emertimi	Realizimi Viti 2022	Realizimi Viti 2023	Realizimi Viti 2024
Paga,shpërblime ,sig.shoqëror	885,685,014	1,107,959,397	1,183,433,028
Materiale, lëndë djegëse	55,245,189	60,043,751	48,127,235
Projekte film,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav. etj	324,466,785	273,139,230	371,718,165
Organizma Ndërkombëtarë	88,889,907	64,213,156	55,184,853
Shërbime nga të tretë	252,156,214	234,318,232	293,406,115
Shpenzime udhëtimi e diëta	40,409,389	37,930,078	32,475,364
Shpenzime të tjera operative	58,488,890	71,536,654	62,530,374
Investime dhe mirëmb. rrjeti digj.	273,185,980	340,147,495	224,974,324
Shpenz.këste e interesa kredie			
TOTALI	1,978,527,368	2,189,287,993	2,271,849,458

Gjatë vitit 2024 krahasuar me periudhat paraardhëse rritjen kryesore e ka zëri i pagave me një vlerë të konsiderueshme prej afër 76 milion lekë me një vit më parë (kryesisht si pasojë e ndryshimit sipas Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.20, datë 30.09.2024, të përlogaritjes së vjetërsisë në punë dhe përshtatjen e saj me VKM Nr.325, datë 31.05.2023, me efekt nga 1 Shtator 2024) dhe pothuajse 300 milion lekë krahasuar me vitin 2022. Po ashtu, pas një rënie në vitin 2023 të shpenzimeve për projekte, blerje të drejtash, shpenzimet gjatë vitit 2024 u rritën me pothuajse 98 million lekë. Rritje gjithashtu ka edhe në zërin e shërbimeve nga të tretë krahasuar me vitin 2023, rritje kjo që përkon me vlerën e shpenzimeve gjyqësore në 2024, siç trajtuam më lartë.

Detyrimet e RTSH-së ndaj të tretëve

Në mënyrë të përmblëdhur, detyrimet dhe ecuria e tyre në 4 tre mujorët e periudhës 31 Mars 2024 deri 31 Dhjetor 2024 paraqiten:

DETYRIME TE:	PERIUDHA:			
	31.03.2024	30.06.2024	30.09.2024	31.12.2024
Drejtoria e Përgjithshme RTSH	154,984,728	115,948,942	170,417,796	209,143,979
Mbartura Njesia Teknike	8,714,453	8,714,453	8,714,453	8,714,453
Total	163,699,181	124,663,395	179,132,249	217,858,432

Ndërsa me të njëjtën periudhë të një viti më parë, detyrimet e RTSH ndaj të tjerëve, krahasimisht janë:

DETYRIME TE:	PERIUDHA:		
	31.12.2023	31.12.2024	Ndryshimi
Drejtoria e Përgjithshme RTSH	164,755,174	209,143,979	44,388,805
Mbartura Njesia Teknike	8,714,453	8,714,453	-
Total	173,469,627	217,858,432	44,388,805

Vihet re një rritje e detyrimeve të RTSH ndaj të tretëve, kryesisht si pasojë e uljes së aftësisë paguese, siç e traftuam më lartë si pasojë e vendimeve gjyqësore detyruar për t'u likuiduar gjatë vitit 2024.

Ndërkohë detyrimet e RTSH ndaj të tjerëve në kontrata shkëmbimi janë në shumën 40,140,979 lekë.

Detyrimi ndaj Ministrisë së Financave për kredinë në vlerën 1,770,147,648 lekë (18,035,126 Euro).

Detyrimi ndaj Deutsche Bank është mbyllur në muajin Shtator 2024.

Gjendja e mjeteve monetare të RTSH, në datën 31.12.2024, është në vlerën gjithsej 38,111,942 lekë.

DREJTORIA JURIDIKE

Drejtoria Juridike e Radio Televizionit Shqiptar, në përmbyshje të rolit të saj institucional, ka ushtruar përgjegjësitë funksionale përgjatë vitit 2024 përmes tre sektorëve të saj përbërës: Sektorit të Marrëdhënieve Ligjore, Sektorit GIS dhe Sektorit të Planifikimit dhe Prokurimeve. Këta sektorë kanë vepruar në bashkërendim për të garantuar zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë

administrative dhe financiare të institucionit, duke përfshirë ndjekjen dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, përfaqësimin ligjor në çështje gjyqësore, si dhe ofrimin e asistencës juridike për strukturat e brendshme të RTSH-së.

Sektori i Marrëdhënieve Ligjore, në përmbushje të përgjegjësiave të tij gjatë vitit 2024, ka ndjekur 66 procese gjyqësore në të cilat Radio Televizioni Shqiptar është palë kryesisht me objekt "Marrëdhëniet e punës" dhe "Shkaktim dëmi", si dhe ka ndërmarrë një sërë veprimesh procedurale për ndjekjen e proceseve gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit.

Për vitin 2024 janë ekzekutuar vendimet me efekt të përkohshëm për 10 individë ish-punonjës, duke u likuiduar një shumë totale prej 63,312,954 lekësh. Këto pagesa janë kryer pavarësisht se ndaj këtyre vendimeve janë paraqitur ankime pranë Gjykatës së Apelit, të cilat aktualisht janë në shqyrtim.

Një sërë padish të tjera janë ndjekur në fazën e gjyimit në shkallë të parë. Në shqyrtim janë ende 24 çështje gjyqësore, të cilat kanë si objekt kryesor zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Pretendimet financiare të paditësve në këto raste kapin vlerën totale prej 45,968,337 lekësh.

Drejtoria Juridike ka ndjekur dhe depozituar në Apel edhe 42 çështje të tjera, ku pala paditëse ka fituar në shkallën e parë. Nëse Gjykata e Apelit do të konfirmojë vendimet përkatëse, RTSH mund të përballet me një detyrim shtesë në vlerën 95,743,246 lekë. Kjo shumë nuk përfshin penaltetet që mund të lindin më pas, siç janë kamatat vonesat, shpenzimet gjyqësore dhe tarifat përmbartimore.

Gjithashtu, pas qasjes proaktive të Drejtorisë së Përgjithshme, pas shtatorit të vitit 2024, janë rikthyer në marrëdhënie pune 12 punonjës që ishin në proces gjyqësor, duke shmangur për miomentin një detyrim potencial për RTSH në masën e 22,730,840 lekëve.

Në analizë të fakteve dhe vendimmarrjeve të gjykatave, konkludohet se shumica e vendimeve të ish-Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me ish-punonjës të RTSH-së janë rrëzuar për shkak të mungesës së arsyeve të qarta, të dokumentuara dhe të ligjshme që justifikojnë largimin e punonjësit nga puna.

Gjatë vitit 2024, Sektori i Planifikimit dhe Prokurimeve pranë RTSH ka zhvilluar një sërë procedurash prokurimi, të ndara sipas natyrës dhe vlerës ekonomike të angazhuar. Aktiviteti është karakterizuar nga një përfshirje e gjerë në blerje shërbimesh, furnizime dhe ndërhyrje infrastrukturore, duke mbuluar nevojat e brendshme të institucionit në mënyrë të vazhdueshme dhe të koordinuar me strukturat teknike dhe prodhuese.

Një pjesë e rëndësishme e procedurave ka qenë blerja me vlerë të vogël. Në këtë kategori janë zhvilluar nëntë procedura për shërbime të ndryshme, si testimi i punonjësve për sigurimin teknik, furnizim me bateri UPS, vendosje në punë e motor-gjeneratorit, blerje baterish alkaline, materiale grimi dhe ndihmëse për IT, vegla muzikore, kablllo, minikonvertera dhe materiale kancelarie. Të gjitha këto procedura janë realizuar mbi bazën e kërkesave të ardhura nga Njësitë Teknike.

Departamenti i Prodhimit, Orkestra Simfonike dhe Drejtoria e Teknologjisë, me vlera që variojnë nga 328.000 deri në 990.000 lekë pa TVSH.

Në kategorinë e tenderave të hapur dhe të thjeshtuar, janë zhvilluar katër procedura me rëndësi të veçantë. Këto përfshijnë blerjen e tonerave dhe drum-ëve për pajisjet e printimit, blerjen e karburantit për një periudhë 8 mujore me një vlerë totale prej 13.286.688.8 lekë, rikonstruksionin e godinës së Atelies së Re dhe një procedurë të kombinuar për blerje pajisjesh elektronike dhe trajnim të stafit. Të gjitha procedurat janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave përkatëse, në respekt të afateve ligjore dhe kërkesave të autoritetit kontraktor.

Gjatë këtij viti janë realizuar edhe dhjetë procedura blerjesh me vlerë nën 100.000 lekë: përfshirë rimbushjen e flikëseve të zjarrit, kontrollin teknik të automjeteve, riparime të mjeteve dhe studiot televizive, furnizime të vogla për qëllime prodhimi dhe diagnostikime teknike të pajisjeve. Këto ndërhyrje, të vogla në vlerë por të domosdoshme në funksion të vazhdimësisë së punës institucionale, janë trajtuar në mënyrë të përshpejtuar dhe në përputhje me kufizimet e përcaktuara nga kuadri ligjor.

Procedurat emergjente kanë qenë një tjetër kategori e angazhuar gjatë vitit. Janë realizuar shtatë ndërhyrje të tilla, si blerja e tonerave dhe bojrave për printera, restaurimi i instrumenteve muzikorë, riparime në sistemet e kondicionimit, zëvendësimi i pjesëve të pajisjeve zyrtare dhe blerja e materialeve për mirëmbajtje teknike. Nevoja për ndërhyrje emergjente ka qenë e diktuar nga situata të paparashikuara të cilat kërkonin zgjidhje të menjëhershme për të mos cenuar ecurinë e punës.

Në zbatim të udhëzimeve për blerjen e biletave të udhëtimit me avion, janë zhvilluar 107 procedura përmes sistemit dinamik, me një vlerë totale prej 12.875.477 lekë pa TVSH. Ky proces është ndjekur në përputhje me Udhëzimin Nr. 3, datë 18.06.2021, duke garantuar transparencë dhe korrektësi në zhvillimin e procedurave të blerjes së transportit ajror ndërkombëtar për stafin e RTSH-së.

Gjithashtu, gjatë këtij viti janë anuluar dhjetë procedura të planifikuara. Shkaqet e anulimeve kanë qenë të ndryshme: tërheqja e operatorëve ekonomikë nga procedurat, dështimi në realizimin e furnizimit pas lidhjes së kontratës, apo mungesa e ofertuesve të kualifikuar për produkte të veçanta si bateri, pajisje ndërtimi, materiale ndihmëse apo grimi. Kjo tregon nevojën për një analizë të thelluar të tregut dhe forcimin e bashkëpunimit me furnitorët për të siguruar realizimin me sukses të të gjitha prokurimeve të planifikuara.

Në përfundim, veprimtaria e Sektorit të Planifikimit dhe Prokurimeve për vitin 2024 ka qenë e strukturuar, voluminoze dhe me një ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin institucional të RTSH. Pavarësisht disa vështirësive të hasura, veprimtaria e realizuar përbën një tregues pozitiv për përmirësimin e proceseve administrative dhe menaxhimin me përgjegjësi të burimeve publike.

Në zbatim të detyrave të veta funksionale gjatë vitit 2024, **Spektori GIS i Regjistrimit dhe Administrimit të Pronave** ka vijuar me identifikimin, verifikimin dhe inventarizimin e pasurive të paluajtshme (asetet) të Radio Televizionit Shqiptar në të gjithë territorin e vendit. Pas

përfundimit të procesit të aplikimit për regjistrim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, jemi në pritje të përmbylljes së regjistrimit të këtyre pasurive.

Procesi i regjistrimit ka përfunduar me sukses për pasurinë publike Ish-Radiostacioni i Fillakës, ndërsa për pasuritë e tjera publike janë realizuar 50 korrespondenca me Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

Megjithëse prioritet kryesor i këtij sektori mbetet pajisja me certifikata pronësie e pronave që administrohen nga RTSH-ja, duke zbatuar në mënyrë të rreptë kuadrin ligjor në fuqi, procesi është përballur me problematika të përsëritura që kanë penguar vijueshmërinë normale të punës.

Gjatë vitit 2024, Sektori GIS i Regjistrimit dhe Administrimit të Pronave në RTSH është hasur me vështirësi të shumta në procesin e regjistrimit të pasurive publike. Një ndër problematikat kryesore ka qenë mungesa e koherencës në përgjigjet e dhëna nga Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK), për shkak të funksionimit jo të unifikuar të sistemit elektronik të ASHK-së, gjë që ka sjellë pasiguri dhe zvarritje të konsiderueshme në trajtimin e kërkesave. Edhe pse janë realizuar mbi 50 korrespondenca me DVASHK-të përkatëse, procesi administrativ për shumicën e pasurive vijon të mbetet i pazgjidhur, duke tejkaluar afatet ligjore të parashikuara. Një tjetër pengesë e rëndësishme ka qenë mungesa e Planeve të Rilevimit, të kërkuara sipas VKM nr. 782, datë 07.10.2020, të cilat përbëjnë dokumentacion të domosdoshëm për përfundimin e procedurës së regjistrimit dhe pajisjen me certifikata pronësie të pasurive të administruara nga RTSH.

DEPARTAMENTI PROGRAMEVE RADIOFONIKE

Radio Tirana ka dëgjuesin besnik, sepse ka realizuar tradicionalisht emisione cilësore me vlera të padiskutueshme, të cilat nuk bien pre e strategjive të komercialitetit duke dëshmuar profesionalizëm, në përmbushje të misionit për dëgjuesin.

Gjatë vitit 2024 ofroi për publikun një larmishmëri tematike, me interes për dëgjuesin, pavarësisht përkatësisë, gjinisë, grupimit social, apo grupmoshës. Sot flasim për një mozaik programor, rikthim të arkivës në cikle nostalgjike, risjellje të vlerave artistike të prodhimeve për fëmijë dhe të rritur.

55 tituj radiofonik, me emisione informativo-argëtues, politik, social-kulturor, sportiv. Radio Tirana tribunë e rëndësishme e debatit për çështje me interes publik, në shërbim të dëgjuesit të saj, me programe dedikuar pakicave dhe shtresave të marginalizuara.

Sot me synimin t'i shërbejë edukimit dhe promovimit të të rinjve ajo ka orientuar prej një viti Radio Tirana 2, si platforma e brezit të ri.

Po kështu me synimin të mbajë gjallë lidhjet me shqiptarët jashtë vendit, t'i informojë ata mbi zhvillimet politiko-ekonomike dhe social-kulturore të vendit, Radio Tirana 3, i dedikohet bashkatdhetarëve tanë jashtë kufijve.

Mbështetur në krijimtarinë më të mirë shqiptare e botërore, me një fond muzikor pasuruar ekskluzivisht nga Orkestra Simfonike të RTSH-së, "Nder i kombit" ka frekuencën model për një dëgues elitar, Radio Tirana Klasik.

Me misionin për t'i takuar të vegjëlvë, Radio Tirana Fëmijë, përgatiti 8 tituj të përditshëm radiofonik, krijuar enkas për ta dhe harmonizuar nga një fond i pasur i muzikës për fëmijë, duke e bërë atë kanal unikale dedikuar fëmijëve.

Tashmë Radio Tirana ka platformën Spotify, me një total prej 390 këngësh, përzgjedhur nga 15 Festalet e fundit të Këngës në RTSH dhe 46 tituj emisionesh radiofonike, me një total prej 7800 episode.

Gjatë kësaj periudhe, Radio Tirana në bashkëpunim me Akademinë e RTSH-së, në përmbushje të misionit, strategjive dhe objektivave institucionalë, për formimin profesional të burimeve njerëzore, ka organizuar trajnime për gazetarët dhe bashkëpunëtorët e saj.

A ka nevoja të paplotësuara e sugjerime që duhen marrë parasysh?

- Jemi në kohë për perfeksionim teknik të studiove regjistrim & transmetim.
- Për rritje të treguesve optimal të cilësisë së zërit që në burim.
- Për investim në vizualizimin e produktit radiofonik.
- Për rivlerësim të tarifave të honorare që janë përpiluar që prej vitit 1994
- Për të paturin e një hallke të munguar që e identifikon, siç është "zëri zyrtar"

QENDRA VENDORE AUDIOVIZIVE RTSH GJIROKASTËR

Gjatë vitit 2024, QVA RTSH Gjirokastrë ka realizuar me sukses misionin e saj si transmetues publik, duke mbuluar në mënyrë gjithëpërfshirëse zhvillimet kryesore të rajonit të jugut. Vëmendje e veçantë i është kushtuar raportimit për çështje të komunitetit, promovimit të trashëgimisë kulturore, gjuhëve të minoriteteve dhe ruajtjes së barazisë gjinore dhe diversitetit. Gjatë vitit janë prodhuar rreth **250 kronika në muaj, 365 edicione informative, 200 emisione televizive dhe radiofonike, 150 dokumentarë dhe reportazhe** si dhe **50 koncerte apo evente kulturore**, duke e bërë Gjirokastrën një nga qendrat më aktive të rrjetit të RTSH-së.

Programacioni ka përfshirë emisione të përditshme dhe javore, me një larmi të tematikave si shëndetësi, arsim, bujqësi, sport, ekonomi, trashëgimi kulturore dhe minoritete. Emisionet janë zhvilluar në gjuhën shqipe, greke dhe arumune, duke respektuar profilin shumëkulturore të rajonit. Gjatë vitit janë realizuar qindra lidhje direkte me edicionet e RTSH1, RTSH2 dhe RTSH24, duke

kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në rrjetin kombëtar. Gjithashtu është ndjekur me korrektësi dinamika e aktivitetit politik, zhvillimet në administratën vendore dhe organizimi i ngjarjeve të rëndësishme lokale e kombëtare.

Spektori teknik ka përballuar me sukses transmetimin e përditshëm, pavarësisht sfidave që lidhen me amortizimin e pajisjeve ekzistuese, mungesën e kamerave moderne dhe nevojën për rinovim të mjediseve të punës. Është vlerësuar puna e palodhur e teknikëve në terren dhe gjatë mbulimit të ngjarjeve në studio dhe ambiente të hapura. Ndërkohë, është evidentuar nevoja për një ndërhyrje të plotë në përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe ndërtimin e një studioje të re moderne.

Nga pikëpamja financiare, janë kryer në kohë të gjitha detyrimet ligjore dhe administrative. Spektori i marketingut ka arritur të sigurojë **57 reklama dhe 7 njoftime publike**, duke gjeneruar të ardhura në vlerën e **1,685,913 lekëve**, ku një pjesë është realizuar në formë kleringu me shkëmbim shërbimesh. Është konstatuar nevoja për një strukturë të dedikuar të marketingut për të rritur të ardhurat dhe për të fuqizuar marrëdhëniet me biznesin lokal.

Për vitin 2025, QVA Gjirokastër ka vendosur objektiva ambiciozë, përfshirë mbulimin me standarde të larta profesionale të procesit zgjedhor të 11 majit, rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimeve televizive dhe radiofonike, ndërtimin e një studioje të re transmetimi dhe zgjerimin e pranisë në platformat digjitale. Prioritet tjetër mbetet intensifikimi i trajnimeve për stafin dhe rritja e bashkëpunimit me bashkitë, shkollat dhe komunitetin, për të rritur ndikimin dhe audiencën e RTSH Gjirokastër në të gjithë qarkun dhe më gjerë.

QENDRA VENDORE AUDIOVIZIVE RTSH SHKODËR

Gjatë vitit 2024, redaksia e RTSH Shkodra ka prodhuar mesatarisht 11 kronika në ditë, duke realizuar në total një fluks të lartë informativ me edicione lajmesh në oraret 15:00, 19:00 dhe 22:00, të cilat kanë zgjatur nga 20 deri në 29 minuta. Prej 1 majit ka nisur një fazë intensive lidhjesh direkte me RTSH 24 dhe RTSH 1, si dhe për emisionin "Mirëmëngjes" në RTSH1. Gjatë vitit janë përgatitur 83 speciale dhe mini-reportazhe, secili me kohëzgjatje mesatare mbi 15 minuta. Emisionet kanë mbuluar tema nga jeta kulturore, sociale dhe historike e Shkodrës, Malësisë së Madhe dhe Vaut të Dejës, duke pasqyruar edhe kontributin e personaliteteve lokale.

Programacioni ditor i RTSH Shkodra është mbështetur në një grilë të qëndrueshme për TV dhe radio, që përfshin emisione si "Mirëmëngjes Shkodër" (214 emisione), "Studio Sport" (38 emisione), "Emocionet e pas ndeshjes" (25 emisione), "Pena e Shkodrës" (49 emisione), "Histori Sportive" (13 emisione), "Rrëfime me buzëqeshje" (7 emisione), "Emocionet e Europeanit" (22 emisione) dhe "Gjurmë Zërash" (30 emisione). Edicionet informative janë transmetuar paralelisht në radio dhe TV, ndërsa lidhjet me kanalet qendrore janë kryer 100% pa ndërprerje.

Sektori teknik ka qenë i angazhuar çdo ditë me prodhimin dhe transmetimin e këtyre materialeve, pavarësisht kufizimeve me pajisjet, kamerat dhe automjetet operative. Aktualisht, puna mbështetet vetëm mbi një automjet funksional. Gjatë vitit janë regjistruar gjithashtu 7 koncerte dhe aktivitete, si dhe janë transmetuar 4 ndeshje futbolli dhe 3 mbledhje të Këshillit Bashkiak në mënyrë direkte. Fondi muzikor është pasuruar me materiale të reja të përpunuara dhe të masterizuara.

Nga pikëpamja financiare, realizimi i buxhetit është bërë me kujdes. P.sh., janë shpenzuar 295,000 lekë nga 417,000 lekë për materiale ndihmëse teknike (71%), ndërsa për materiale kancelarie dhe pastrimi 129,000 lekë nga 132,000 lekë (98%). Për energji janë shpenzuar 1,426,000 lekë nga 1,400,000 lekë (102%) dhe për internet 287,000 lekë nga 261,000 lekë (110%). Në disa zëra të rëndësishëm, si honorarët (1,240,000 lekë nga 2,000,000 lekë) dhe dieta (72,000 lekë nga 200,000 lekë), realizimi ka qenë nën pritshmëritë për shkak të kufizimeve financiare dhe operacionale. Po ashtu, për qira pajisjesh janë shpenzuar vetëm 120,000 lekë nga 400,000 lekë (30%).

Vështirësi janë hasur në sigurimin e të ardhurave nga marketingu, për shkak të mungesës së një specialisti marketingu në strukturë (pozicion që ekziston në QVA Korçë dhe Gjirokastër), si dhe për shkak të konkurrencës nga televizione lokale me traditë më të gjatë. Gjendja e studios, përfshirë ndriçimin dhe pajisjet teknike, ka penguar realizimin e disa emisioneve të planifikuara. Faqja zyrtare e RTSH Shkodra në Facebook me rreth 14 mijë ndjekës është hakëruar në gusht 2023, dhe aktualisht po punohet për rritjen e një faqeje të re, ndërkohë që përmbajtja publikohet rregullisht edhe në YouTube dhe faqen www.rtsh-shkodra.live.

Për vitin 2025, objektivat e RTSH Shkodra përfshijnë rritjen e cilësisë së edicioneve informative, zgjerimin e mbulimit territorial, afirmimin e të rinjve në media, si dhe ndërtimin e programeve që ndërthurin transmetimin tradicional me platforma digjitale. Institucioni synon të forcojë kapacitetet e veta teknike dhe të sigurojë një mbështetje më të madhe buxhetore për të përmbushur misionin publik në nivel lokal dhe kombëtar.

QENDRA VENDORE AUDIOVIZIVE RTSH KUKËS

Gjatë vitit 2024, QVA Kukës ka pasqyruar ngjarjet më të rëndësishme lokale dhe rajonale në radio dhe televizion, duke rritur sasinë dhe cilësinë e prodhimeve. Në fokus kanë qenë problematikat sociale, aktivitetet kulturore, përvjetorët historikë dhe sfidat e përditshme të komunitetit. U shënua 65-vjetori i Radio Kukësit dhe 5-vjetori i RTSH Kukësit me aktivitete përkujtimore. Vështirësitë infrastrukturore nuk kanë penguar përfshirjen e kronikave dhe lidhjeve në RTSH 1, 2 dhe 24.

Radio Kukësi transmeton 24 orë në frekuencën 100.4 MHz, me 4 orë transmetime live ditore. Është realizuar një program muzikor i pastruar dhe i përshtatshëm për të gjitha moshat, ndërsa fonoteka ruan afro 8700 tituj që presin dixhitalizimin. Janë zhvilluar emisione të përditshme si “Radiomëngjesi” dhe të përjavshme sipas fushave. RTSH Kukës ka pasur përmbajtje të pasur nga Kukësi, Kosova, Tropoja, Dibra etj., me një studio moderne, por pa sinjal të drejtpërdrejtë lokal. Emisionet përgatiten dhe dërgohen në Tiranë për transmetim.

Me një staf prej 6 gazetarësh, 2 kameramanë dhe një redaktor muzike, redaksia është fokusuar te prodhimi i edicioneve informative dhe kronikave për RTSH Kukës dhe rrjetin kombëtar. Janë realizuar 637 emisione radiofonike dhe 343 nga bashkëpunëtorët, 2190 kronika TV dhe 2010 radiofonike. Për RTSH 1, 2 dhe 24 janë dërguar 540 kronika dhe janë prodhuar 51 dokumentarë/intervista. Në total, u transmetuan 1620 edicione informative. Emisioni festiv “Gëzuar me RTSH Kukësin” rezultoi i ndjekur gjerësisht.

Gjatë vitit 2024, gazetarët e Qendrës Vendore Audiovizive RTSH Kukës kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve mediatike në të dy platformat, radio dhe televizion. Secili gazetar ka pasur detyra të përcaktuara qartë sipas profilit tematik, duke realizuar emisione periodike javore, kronika të përditshme, dokumentarë, reportazhe dhe lidhje direkte me edicionet kombëtare të RTSH. Në mënyrë të vazhdueshme, janë përgatitur materiale për RTSH Kukës, si edhe për kanalet kombëtare RTSH 1, RTSH 2 dhe RTSH 24. Në mënyrë të përgjithshme, çdo gazetar ka kontribuar me dhjetëra kronika televizive dhe radiofonike, me një mesatare prej tre deri në katër kronika në ditë, si dhe me emisione të dedikuara sipas fushës së mbulimit (si “Radiomëngjesi”, “Aktualitet”, “Dritë”, “Rubrika Sportive”, “Shëndet e jetë” etj.). Po ashtu, është theksuar pjesëmarrja aktive në lidhje të drejtpërdrejta me programet informative të mëngjesit në RTSH. Kontributi i gazetarëve ka qenë i gjithanshëm, duke përfshirë kronika nga rajone si Kosova, Tropoja, Dibra e Hasi, dhe duke pasqyruar me profesionalizëm realitetin social, kulturor dhe ekonomik të zonës. Kjo punë intensive është reflektuar në rritjen e ndjeshme të shikueshmërisë dhe ndjekjes në rrjetet sociale të RTSH Kukës.

Emisionet e prodhuara nga bashkëpunëtorët kanë sjellë vlera të reja në programacion. Emisioni i fëmijëve është vlerësuar si një nga më të mirët. Të gjitha emisionet e bashkëpunëtorëve kontrollohen dhe mbështeten në skenarë të miratuar.

Spektori teknik përballlet me mungesë pajisjesh dhe studioje për prodhime televizive. Përmirësimet janë bërë në nivel figurash dhe zëri, por pajisjet janë të vjetra, përfshirë pulstin e transmetimit 24-vjeçar. Nevojitet pajisje e re për montazh, sistem ndriçimi dhe një gjenerator. Disa ndërprerje në transmetim janë shkaktuar nga probleme strukturore në studiot ekzistuese.

Gjatë vitit 2024, janë respektuar detyrimet financiare dhe ligjore, përfshirë pagat, honoraret dhe udhëtimet. Janë bërë raportime të përditshme dhe ruajtje e rregullt e dokumentacionit të personelit. U shtuan tre gazetarë të rinj që kanë nevojë për kualifikim. Problem ka qenë mungesa e furnizimit me naftë dhe mungesa e një automjeti funksional, gjë që ka rritur koston e operimit.

Të ardhurat nga reklamat mbeten modeste për shkak të mungesës së kulturës së sponsorizimit dhe mungesës së transmetimit të drejtpërdrejtë. Masat e sigurisë në objekt janë respektuar, me staf të përkushtuar në recepsion dhe dezinfektim periodik të ambienteve.

QVA Kukës synon të prodhojë sinjalin televiziv lokal dhe të zhvillojë emisione të plota nga studiot e veta. Ka projekte konkrete për ndriçim, dekor dhe sinjal, si dhe bashkëpunime me RTK.

dhe RTV 21. Prioritet do të jetë rritja e cilësisë së programacionit, trajnimi i stafit, përmirësimi i etikës së punës dhe sigurimi i financimeve të nevojshme për pajisje dhe teknologji.

QENDRA VENDORE AUDIOVIZIVE RTSH KORÇË

Gjatë vitit 2024, Qendra Vendore Audiovizive RTSH Korçë ka vijuar me përkushtim misionin e saj si pjesë e rrjetit radioteleviziv publik shqiptar, duke punuar në përputhje me statutin e RTSH dhe parimet editoriale. Stafi, i përbërë nga gazetarë, teknikë dhe kameramanë, ka realizuar një sërë emisionesh, kronikash, bisedash dhe telereportazhesh, duke mbuluar vazhdimisht ngjarjet më të rëndësishme të qarkut. Janë prodhuar më shumë se 2200 orë transmetim gjatë vitit, me mbi 2940 kronika lajmesh të zhanreve të ndryshme, një pjesë e të cilave janë transmetuar edhe në RTSH 1, RTSH 2 dhe RTSH 24. Gjithashtu, janë realizuar 98 speciale dhe biseda për grilën programore të RTSH 2, 110 lidhje direkte me emisionin "Mirëmëngjes Shqipëri" dhe 214 lidhje për edicionin e mëngjesit në RTSH 24. RTSH Korça ka mbuluar edhe ndeshjet e Skënderbeut në Superligë për emisionin "Super Gol", si dhe ka përgatitur mbi 20 orë program festiv për fundvitin, duke përfshirë aktivitete për të gjitha moshat dhe grupet shoqërore.

Në Radio Korça janë transmetuar lajme të përditshme në disa orare, si dhe edicione në gjuhën maqedonase. Emisionet live kanë përfshirë "Thuaj Mirëmëngjes" dhe "Studio Sport". Në total, janë realizuar 290 emisione për radio dhe 4 të regjistruara në studio për transmetim televiziv.

Spektori i Web-it ka treguar rritje domethënëse në ndjekje dhe ndërveprim, me një strategji për shfaqjen në kohë reale të ngjarjeve lokale. Shikueshmëria në Facebook është rritur nga 31.000 në 42.053, ndërsa në Instagram nga 700 në 1.045. Transmetimet live të festave fetare dhe sportive kanë arritur deri në 1.5 milion shikime, pavarësisht mungesës së një gazetari të dedikuar për Web.

Nga pikëpamja financiare, plani i shpenzimeve për vitin 2024 ishte 9,291,713 lekë, ndërsa realizimi arriti në 6,295,256 lekë. U bënë investime në pajisje kompjuterike, kondicionerë, rikonstruksion ambientesh dhe sisteme sigurie. Shpenzimet më të larta shkuan për honorare, shërbime dhe materiale ndihmëse. Të ardhurat totale të xhiruara ishin 2,342,020 lekë, ku përfshihen të ardhura nga reklamat, kontratat klering dhe spotet publicitare.

Spektori i montazhit ka qenë mjaft aktiv, duke realizuar regjistrimin dhe montimin e të gjitha emisioneve të përmendura, si dhe 32 koncerte, 98 intervista, 5 dokumentarë dhe 2940 kronika. Montimet janë bërë në mënyrë të përditshme për lajmet dhe emisionet më të rëndësishme, përfshirë programin festiv të fundvitit.

Spektori i transmetimit ka funksionuar rregullisht përgjatë vitit, me transmetime direkte të emisioneve "Thuaj Mirëmëngjes" dhe "Studio Sport", si dhe emisioneve të tjera javore sipas një orari të mirëpërcaktuar. Nga tetori 2024 nisi sezoni i ri televiziv me disa emisione të reja. Është bërë përdorim i Green Screen-it për rritjen e cilësisë vizuale. Janë hasur edhe disa probleme teknike, përfshirë defekte në mikrofonat dhe serverin e transmetimit, të cilat janë zgjidhur në mënyrë efektive nga stafi teknik.

DREJTORIA E INFORMACIONIT DHE TEKNOLOGJISË

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e IT-së ka konsoliduar operacionet bazë duke synuar arritjen e një disponueshmërie të lartë të sistemeve kritike dhe eficiencë në ofrimin e shërbimeve teknike. Në bashkëpunim të ngushtë me njësitë tjera të RTSH-së u realizuan ndërhyrje planifikuese për përmirësimin e rrjeteve lokale në degët kryesore (p.sh., RTSH 24 dhe platforma Web), ku rezultoi ulje e vonesave në qarkullimin e të dhënave dhe përmirësim i performancës së aplikacioneve të brendshme. Administrimi proaktiv i pajisjeve ekzistuese (serverë, storage, etj.) siguroi stabilitet operativ në nivele mbi 99% uptime në shërbimet kyçe, duke reduktuar rastet e ndërprerjeve jo-planuara.

Në fushën e komunikimit elektronik institucional, shërbimi i postës mbeti i pandërprerë dhe me integritet të ruajtur; politika të avancuara filtrimi dhe monitorimi ishin efektive në bllokimin e rreth 60 email-eve të dyshimta ose me malware gjatë vitit, çka kontribuoi në mbrojtjen e përdoruesve dhe mbajtjen e reputacionit të domenit të RTSH-së. Proceset e backup-it dhe arkivimit u forcuan përmes zbatimit të teknologjisë LTO për ruajtje offline, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arkivit; kjo masë siguron mbrojtje nga humbja e dhënash afatgjatë dhe lehtëson rikthimin e tyre në rast nevojë, duke vendosur baza për rritje të kapaciteteve sipas volumit në rritje të materialeve multimediale.

Ndihma teknike e ofruar nga Help Desk-i dhe ekipi i infrastrukturës u menaxhua me efektshmëri, ku mesatarisht kërkesat e nivelit 1 u zgjidhën brenda pak orësh; stafi teknik asistoi në konfigurimin e pajisjeve të reja dhe në mirëmbajtjen e stacioneve të punës, duke reduktuar kohën e ndërprerjeve për përdoruesit. Për ngjarje të veçanta si Festivalin e Këngës, Drejtoria e IT-së ofroi mbështetje të posaçme për sistemin e televotimit—përfshirë teste para eventit, sigurimin e serverëve rezervë dhe monitorimin në kohë reale—që garantuan besueshmëri dhe integritet në procesin e votimit.

Megjithatë, sfidat e vitit ishin evidente: prodhimi i vazhdueshëm multimedial shkaktoi nevojë të përhershme për zgjerim të kapacitetit të ruajtjes (storage), ku propozimet për blerje të pajisjeve shtesë mbetën ndër prioritetet kryesore. Vonesa në shkëmbimin e pajisjeve të amortizuara ndikoi në ritmin e disa ndërhyrjeve, duke kërkuar monitorim të shtuar dhe riparime emergjente, ndërsa mungesa e një plani të përditësuar për zëvendësim të inventarit teknik imponoi sires mbi buxhetin ekzistues.

Në aspektin e sigurisë kibernetike, infrastruktura ekzistuese bazohej në një firewall të gjeneratës së vjetër që nuk ofronte mbrojtje të shtresuar me kapacitete të avancuara IDS/IPS. Menaxhim qendrorizuar të politikave dhe integrim me një platformë SIEM. Kjo nxori në pah rrezikun për sulme të mundshme dhe nevojën urgjente për investim në pajisje të reja të sigurisë, që të lehtësojnë kontrollin e trafikut sipas politikave institucionale, mbrojtjen proaktive ndaj kërcënimeve, dhe aftësinë për raportim dhe analizë qendrore.

Nga ana e stafit, Drejtoria shfaq angazhim të lartë në përmbushje të detyrave ditore dhe ofroi reagim profesional ndaj incidentëve, por sfidat komplekse të sigurisë kërkojnë shtim të kapaciteteve njerëzore me profil të specializuar në fushën e kibernetikës (p.sh., analistë SOC, ekspertë në menaxhimin e incidentëve, etj.). Nevojitet edhe një plan trajnimi dhe certifikimi për stafin ekzistues, si dhe rekrutimi i të paktën një ose dy specialistëve të sigurisë për të strukturuar një qendër të vogël operacioni sigurie (SOC) brenda Drejtorisë.

Si përfundim, rekomandohet vijimi i modernizimit të infrastrukturës me prioritet investimin në një firewall të gjeneratës së re dhe në zgjidhje SIEM, zgjerimin e kapaciteteve të storage-it sipas planit të rritjes së prodhimit multimedial, dhe krijimin e një strukture të dedikuar të kibernetike (përfshirë procese incidente, monitorim 24/7 dhe trajnime). Një plan i qartë zëvendësimi të pajisjeve të amortizuara, së bashku me një buxhet të mirëmunduar për blerje të ri-infrastrukturës, do të sigurojë që qëndrueshmëria, performanca dhe mbrojtja e sistemeve të RTSH-së të jenë në përputhje me kërkesat aktuale operacionale dhe të reduktojnë rreziqet teknike në të ardhmen.

DREJTORIA E SHITJES DHE PROMOCIONIT

SEKTORI I SHITJES

Spektori i Shitjes, gjatë periudhës Janar 24 - Dhjetor 24, ka lidhur me subjekte të ndryshme 84 kontrata nga 63 në total për vitin 2023 për Reklama dhe Sponsorizime me vlere 92.073.722 ku përfshihen edhe 9 kontratat për të drejtën e transmetimit të kanaleve të RTSH.

Në vijim të punës të përditshme gjatë kësaj periudhe janë trajtuar nga Spektori i Shitjes 156 kërkesa për marrje materiale me Klering, të cilat janë realizuar në masën 95% të kërkesave. Ka qenë e pamundur realizimi i kërkesave për blerje materiale profesionale si edhe ato të kancelarive dhe të printimeve.

Rakordimet me klientët, ndjekja e shlyerjes të detyrimeve si dhe njoftimet periodike për debitorët janë pjesa tjetër e punës së përditshme në këtë Sektor.

Nga Spektori i Shitjes janë hartuar Paketat dhe strategjitë e shitjes të Kampionatit Shqiptar të Futbollit "Abissnet Superiore" si evenimenti kryesor Sportiv i vitit. Janë kontaktuar të gjitha Subjektet dhe Agjensitë që operojnë në treg duke i klasifikuar sipas kategorive që përfaqësojnë. Për këtë arsye janë krijuar 3 Paketa Sponsorizimi me vlera 30.000 Euro, 20.000 Euro dhe 10.000 Euro. Gjithashtu janë aplikuar paketa për spote të lira, të përshtatura për nevojat e klientëve të ndryshëm.

Gjithashtu janë hartuar dhe shpërndarë Ofertat publicitare për Fest 63, Lojërat Olimpike, UEFA Europa/Conference League, Eurovision Song, si dhe Oferta për të gjitha programet e Strukturës të RTSH, përfshirë këtu edhe programet e reja si 3D nga A. Dudushi, Pasditja ime, e Diela Jone,

Jetë Shqiptare, Europiani 3D, Zona 30, Rubrika Sportive apo serialet televizive që kanë startuar në Sezonin e ri etj.

Sektori i Shitjes gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, ka realizuar të ardhura në vlerën totale prej 92,073,722 Leke. Këto të ardhura janë +28% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kontribut të lartë në këtë rritje kanë dhënë të ardhurat e gjeneruara nga Festivali i 63 i Këngës së RTSH, rreth 220,000 Euro, rreth 60% më shumë se viti i kaluar. Këto të ardhura janë rritur rreth 80% më shumë krahasuar me Fest 62.

Eventet sportive kanë luajtur rol në të ardhurat e 2024, duke përmendur këtu UEFA UCHL në fazat finale (Shkurt – Maj 2024), Lojërat Olimpike “Paris 2024”, Euro 2024 i cili edhe pse nuk u transmetua nga RTSH, u krijuan programe të dedikuara si Europiani 3D.

Rritje kane patur gjithashtu edhe të ardhurat nga QVA në masën 46% ne total. Nga këto RTSH Korca ka patur rritjen më të lartë nga 2,935,697 Leke gjatë 2023, në 4,712,865 Leke gjatë 2024, rreth 61% shumë. RTSH Gjirokastra gjithashtu ka rritur të ardhurat në masën 44% nga viti në vit.

Rakordimet me klientët, ndjekja e shlyerjes të detyrimeve si dhe njoftimet periodike për debitorët përbëjnë pjesën tjetër të punës së përditshme në këtë Sektor.

Nga lista e debitorëve ndaj RTSH janë kryer përpjekje të vazhdueshme nga Drejtoria e Shitjes dhe Promocionit për uljen e borxhit ndaj RTSH. Për këtë arsye jemi në proces negocimi me MEDIA UNION, për të marrë shërbimin e servisit të makinave nga partneri i saj AUTOMASTER. Kjo do të ulte detyrimin total të Media Union ndaj RTSH.

Gjithashtu jemi në diskutime me EUROSIG për të marrë shërbimin e vendosjes së GPS të makinave të RTSH dhe sigurimin e pasurive të paluajtshme, cka do të ulte gjithashtu detyrimin total të EUROSIG.

Një pjesë e debitorëve ndaj RTSH janë agjensitë e reklamave, të cilët kanë terma pagese të gjata, krahasuar me klientët e drejtpërdrejtë të RTSH, cka rrit artificialisht debinë e tyre ndaj RTSH. Gjithsesi janë bërë përpjekje për të ulur këto terma në të ardhmen.

Për sa i perket Digitalb detyrimet e këtij të fundit janë pothuajse të barabarta me faturimet e tij ndaj RTSH. Kjo nuk ndikon në rritjen e borxhit në total ndaj RTSH.

Subjekti ARTMOTION është kontaktuar rregullisht për detyrimet e prapambetura, por nuk është marrë asnjë reagim prej tyre. Për këtë arsye ky subjekt është raportuar për ndjekje nga Drejtoria Juridike.

SEKTORI I PROMOCIONIT

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 është kryer sistemimi dhe riorganizimi i mënyrës të promovimit të programeve në TV, Radio dhe mediat Sociale. Fushatat e promocionit kanë qenë gjithëpërfshirëse në rrjetin e RTSH dhe të targetuara sipas kaneleve dhe programeve specifike. Sektori i promocionit tashmë menaxhon hapësirat promovuese në të gjitha kanalet e rrjetit të RTSH si dhe hapësirat e promocionit në Rrjetet sociale dhe WEB.

Nga ana e sektorit të promocionit janë përcaktuar në mënyrë të detajuar mënyrat e promovimit për çdo program, si më spote, postera, pop-up edhe me të ftuar në Studio, Kronika Informativë në lajme apo edhe me shkrime në WEB, duke bërë të mundur promovimin në çdo hapësirë që ka në dispozicion ky sektor.

Bazuar në detyrat e ngarkuara promovimi i programeve apo eventeve, është realizuar si më poshtë:

1.Krijimi i përmbajtjes, ndjekja e zbatimit dhe shpërndarjen për Promo të përgjithshme, spote të dedikuara për programe dhe evente të ndryshme, Kulturore sportive, ndeshje, apo emisione.

2.Krijimi i përmbajtjes për Spote të dedikuara për Radio dhe TV, për evente ekskluzive, si: Champions League, Euro League, Kampionatet kombëtare të Futbollit; Festivali i RTSH, Eurovision etj

3.Krijimi i përmbajtjes për Spote të dedikuara për Social Media, për eventin ekskluziv si UEFA Champions League; Uefa Europa League; Abisnet Superiore; Kategoria e parë; Euro League

4.Ndjekja e Spoteve të dedikuara, për të gjithë gamën e emisioneve që ofron rrjeti RTSH.

5.Hartimi i strategjive promovuese, për Social Media.

6.Hartimi i skaletës ditore për Publikimet në Social Media.

7.Krijimi i strategjive promovuese për Sezonin e Ri televiziv, duke përfshirë: Spote, Video Reels, Fotosesion, Postera grafik, Banner, për të gjithë emisionet e sezonit të ri.

8.Koordinimi me kanalet që ofron rrjeti i RTSH, për marrjen e informacionit që shërben për promovim të kanaleve.

Gjatë periudhës janar 2024 - 2025, puna nga sektori i promocionit ka qenë e fokusuar në krijimin, prodhimin, ndjekjen, zbatimin dhe shpërndarjen e të gjitha materialeve promovuese si: spotet, prome, pop up, postera, banera për të gjitha kanalet televizive, radiofonike dhe rrjete sociale: RTSH1, RTSH2, RTSH3, RTSH plus, RTSH Sport, RTSH Film, RTSH Shqip dhe Radio Tirana 1, RTSH Satelit.

Në funksion të programacionit të kanaleve të RTSH-së në faqet zyrtare online, përkatësisht në rrjetet sociale Facebook, Instagram, si më poshtë, për periudhën (Janar 2024 - 2025) janë promovuar rreth 100 programe nga departamenti i Promocionit, por në varësi të programacionit të RTSH-s numri i programeve për promovim mund të rritet si psh gjatë kësaj periudhe janë shtuar programe si: Voa zëri i Amerikës, Në folenë e shqiponjave e shumë të tjera, cikle dokumentarësh, serila etj...

● (Facebook) RTSH- Radio Televizioni Shqiptar

● (Instagram) @rtshqiptar

Kontenti i publikuar në faqet zyrtare online, promovon programacionin e rrjetit RTSH, gjithëpërfshirës për të gjithë kanalet e dedikuara, lajmin përmes faqes zyrtare në web: rtsh.al dhe programet artistike të Orkestrës Simfonike të RTSH-së.

Ky kontent shfaqet në forma të ndryshme, duke pasur një bashkëpunim të ndërsjelltë me sektorin e grafikës dhe me departamentet përkatëse të kanaleve apo informacionit, për marrjen e materialit promovues.

Mënyrat e promovimit janë realizuar, si më poshtë:

- ☐ Poster grafik, për kontentin përkatës.
- ☐ Promo- Video/ Spot, për kontentin përkatës. Promo e cila realizohet edhe për formatin on-air, në këtë rast formatohet për on-line.
- ☐ Reels ose Igtv - Qasja që të ofron rrjeti Instagram për video më specifike, të detajuar lidhur me kontentin përkatës.
- ☐ Foto Live - Fotot cilësore të realizuara nga fotografi zyrtar pranë sektorit të grafikës, në RTSH.
- ☐ Format Story (Instagram dhe Facebook)

Programet që janë promovuar në periudhën si më lart, për kanale të dedikuara, janë përkatësisht:

Me këtë strukturë të re dhe një qasje inovative, Sektori i Promocionit në RTSH synon të rrisë audiencën dhe ndërveprimin me publikun, duke vendosur një standard të ri në promovimin e përmbajtjes mediatike në Shqipëri. Përmes strategjive multimediale dhe angazhimit të vazhdueshëm në rrjetet sociale, RTSH forcon identitetin e saj si transmetues publik lider në vend.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Drejtoria ka përgjegjësinë kryesore për sigurimin e funksionimit efikas të shërbimeve logjistike, teknike dhe administrative që mbështesin realizimin e misionit të RTSH-së si OSHMA, duke garantuar ofrimin e shërbimeve për publikun në fushat e informimit, edukimit dhe argëtimit. Roli i saj konsiston në koordinimin dhe mbështetjen e operacioneve për njësitë programore dhe prodhuese, si dhe administrimin e burimeve fizike dhe njerëzore në përputhje me kërkesat institucionale.

Sektori i Arkiv-Protokollit ofron shërbimet e administrimit dhe arkivimit të dokumentacionit zyrtar, si dhe menaxhimin e protokollit për korrespondencën hyrëse e dalëse. Ky funksion është thelbësor për ruajtjen e integritetit dhe gjurmueshmërisë së dokumenteve, si dhe për garantimin e komunikimit të rregullt me palët e brendshme e të jashtme të institucionit.

Sektori Mbështetës, përfshirë recepsionin dhe punonjësit e pastrimit, siguron shërbime administrative themelore që mbështesin stafin e RTSH-së dhe mysafirët në ambientet televizive e radiofonike. Megjithatë shpesh nënvlerësohen, këto pozicione janë kritike për mirëfunksionimin e përditshëm dhe për krijimin e një ambienti të rregullt e të mirëorganizuar për transmetimet dhe pritjet zyrtare.

Sektori i Transportit menaxhon flotën e automjeteve për nevojat e transmetimeve televizive, radiofonike, edicionet informative dhe ngjarjet sportive. Me rritjen prej 70% të kërkesave pas marrjes së kampionatit Shqiptar në gusht 2024, ky sektor ka arritur të reduktojë konsumin e karburantit dhe kostot e mirëmbajtjes përmes kontratave të negociuara me operatorë ekonomikë, si dhe të implantojë një sistem GPS për monitorim real-koha, duke përmirësuar efikasitetin operativ dhe sigurinë e lëvizjeve.

Sektori Teknik dhe Mirëmbajtje siguron funksionimin e përditshëm dhe sigurinë e infrastrukturës fizike të RTSH-së, duke mbuluar mirëmbajtjen, riparimin dhe menaxhimin e sistemeve hidraulike, ngrohje-ftohje dhe strukturës së ndërtesave. Përveç asistencës teknike për ngjarje të drejtpërdrejta si Festivalin e 63-të të Këngës, gjatë vitit janë përfunduar rikonstruksionet e dy studiove kryesore (RTSH 24 dhe salla e madhe e Orkestrës), duke përmirësuar parametrat profesionalë të prodhimit.

Megjithëse Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse klasifikohet me risk të ulët dhe nuk ka qenë objekt auditimi të brendshëm apo nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në proceset e brendshme është evidentuar nevoja për përmirësim të procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Kjo nënkupton rishikim dhe standardizim të praktikave ekzistuese për të siguruar transparencë dhe përputhje me rregulloret ligjore.

Si sfida kryesore identifikohen procedurat e paefektshme të prokurimit, që shpesh çojnë te kapacitete jo në përputhje me nevojat (p.sh., mirëmbajtja e automjeteve). Masat korrigjuese të propozuara përfshijnë trajnimin e stafit në zbatimin e procedurave të prokurimit, rishikimin e rregulloreve të brendshme dhe hartimin e një Kodi Etik për menaxhimin financiar dhe kontraktor, me qëllim forcimin e kontrollit dhe konsistencës në blerje dhe shpenzime.

Për vitin e ardhshëm, prioritetet strategjike përfshijnë përmirësimin e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e burimeve financiare, përmes trajnimeve periodike mbi menaxhimin financiar dhe etikën profesionale. Gjithashtu synohet konsolidimi i procedurave të prokurimit, implementimi i rregulloreve të përditësuara interne dhe ndërtimi i mekanizmave të monitorimit e raportimit për ndjekjen e buxheteve dhe kontratave. Këto nisma pritet të rrisin besueshmërinë dhe performancën e Drejtorisë në mbështetje të misionit të RTSH-së.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Drejtoria e Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2024 ka patur një fluks të madh pune, kryesisht në rekrutimet dhe plotësimet e stafit të punës.

Sistemi i plotësimit të vakancave është bërë me shpallje pozicionesh në faqen zyrtare ose me propozime të drejtuesve të strukturave.

1. Mbulimi i Strukturës Organizative

Muaji	Plani	Faktikisht	Përqindja e realizimit
Janar 2024	1040	979	94.1 %
Dhjetor 2024	1041	1022	97.8 %

2. Lëvizjet e Stafit dhe Veprimtaria Administrative

Vendime	Numri
Emërime	144
Lëvizje në detyrë	97
Komandim	11
Zëvendësim në detyrë	16
Largim me shkelje	12
Lirim nga detyra me VKD	1
Braktisje e vendit të punës	16
Dorëheqje	60
Largim humbje jete punonjësi	2
Dalje në pension	11
Largime paaftesi pune	1
Punësime	146
Largime	103

Si veprimtari statistikore kjo drejtori ka trajtuar:

Akte	Numri
Vendime	250
Vendime dhe masa disiplinore	68
Ndihma financiare për punonjësit rast sëmundje ose fatkeqësie familjare	67
Kontrata individuale pune	271
Kontrata për rojet përsëritsa	49
Vërtetime pune dhe page për punonjësit	120
Kërkesa të trajtuara si informacion, ankesa, vënje dokumentacioni në dispozicion	91

3. Veprimtaria e Akademisë dhe trajnimi i stafit

Aktiviteti	Numri	Punonjës pjesëmarrës
Trajnime	5	166
Seminare	3	16
Kurse të gjuhës angleze	1	10

Angazhime kryesore:

- Bashkëpunim me Programin Kombëtar të Praktikave të Punës (Shtator-Dhjetor 2024);
- Bashkëpunim me Radio Suedeze SR MDO, Goethe Institute dhe Deutsche Welle Akademie;
- Hartim dokumenti analitik për Njësinë e Inteligjencës së Biznesit;
- Përgatitje liste kursesh për EBU Akademi (teknikë, ueb, gazetari);
- Ndjekje e kursit të gjuhës angleze, niveli B1+ pranë RTSH;
- Trajnime dhe seminare mbi zhvillimin profesional, menaxhimin e lajmeve, transformimin digjital dhe komunikimin mediatik;
- Pjesëmarrje në projektin e EBU dhe TG4 për Paketën e Mjeteve Neurodiversive;
- Vizita studimore në Stokholm, Asamble në Lozanë, aktivitet në Shkup dhe vizita pune në Kukës dhe Shkodër.

Problematikat kryesore

- Gjatë vitit 2024 pati një përmirësim në rekrutim dhe plotësim vakancash, por gjithashtu pati një qarkullim të lartë të punonjësve si largimet nga puna, dorëheqjet dhe braktisjet e cila kërkojnë nevojën e analizës së faktorëve të pakënaqësisë dhe krijimit të mekanizmave motivues.
- Volumi i lartë i trajtimit të dokumentacionit justifikon nevojën për dixhitalizim dhe automatizim të proceseve për të përmirësuar eficiencën.
- Pjesëmarrje e kufizuar në trajnime në raport me numrin total të stafit.

DREJTORIA E ARKIVIT

Drejtorja e Arkivit ka arritur të shtojë numrin e aseteve digjitale të arkivuara në krahasim me vitet paraardhëse dhe njëkohësisht shënon si arritje të rëndësishme në veprimtarinë e saj digjitalizimin e materialeve arkivore audio.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 Drejtoria e Arkivit ka kryer këto veprimtari:

- Arkivim dhe redaktim materialesh audiovizive
- Janë arkivuar në sistemin MAM Etere 24376 (5137 orë) asete të materialeve arkivore audiovizive të kategorive të ndryshme si film artistik, film dokumentar, film serial, emisione të gjinive

të ndryshme (artistike, ekonomike, muzikore, politike), spektakle, kronika të lajmeve, speciale, reportazhe, materiale bruto etj.

- Janë arkivuar në sistemin MAM Etere 1485 (85 orë) asete të materialeve arkivore audio, kryesisht festivale ndër vite, koncerte të pranverës, këngë të muzikës popullore, këngë të muzikës së lehtë etj.

- Janë redaktuar (përpunuar) në sistemin MAM Etere 146793 minuta (2437 orë) materiale arkivore audio-vizive të kategorive të ndryshme si film artistik, film dokumentar, film serial, emisione të gjinive të ndryshme (artistike, ekonomike, muzikore, politike), kronika të lajmeve, speciale, reportazhe, materiale bruto etj. Redaktimi i këtyre materialeve është realizuar mbi bazën e një konceptimi audioviziv në përputhje me Rregulloren e Arkivit sipas të gjitha kërkesave klasifikuese në mënyrë të detajuar me planë, sinkrona, intervista, inserte të vlefshme për shfrytëzim.

- Mirëmbajtje të filmit 16 mm

- Është kryer kontroll periodik dhe sistemim i vazhdueshëm i Fondit Arkivor të Film 16 mm duke ndjekur sigurinë e kushteve teknologjike në fond si dhe duke mbajtur evidencë ditore për temperaturën dhe lagështirën. Gjithashtu ka vijuar procesi i përpunimit dhe restaurimit të fondit me film 16 mm cili konsiston në përpunimin paraprak teknik: ajrosje, konservim, sistemim, pastrim nga puhurat dhe ngjitje të kuadrove të dëmtuar. Janë përpunuar në total 161902 metra film + pistë të zhanreve telerevista, politiko shoqëror, ekonomik, artistik, art figurativ, muzikor, shkencor, arsim kulturë dhe sport.

- Është kryer monitorim i vazhdueshëm në sistemin MAM Etere në lidhje me krijimin e aseteve (arkivimin) për materialet që prodhohen dhe transmetohen në RTSH.

- Nisja e Procesit të Digjitalizimit të materialeve Audio

- Janë digjitalizuar materiale arkivore muzikore audio (Orkestra Simfonike e RTSH-së, Festivale të Rretheve, Konkurse të Zërave të Rinj, Takime të Ansambleve Amatore, Pjesërisht Festivale të Këngës në RTSH, Koncerte të Pranverës) dhe materiale arkivore audio nga Fondi i Folur (Teatri në Mikrofon, Fjala Artistike në Mikrofon, Emisione dhe Konkurse për Pionierë). Gjithsej në total në periudhën janar – dhjetor 2024 janë digjitalizuar 71987 minuta (17 % e materialeve në total).

- Përgatitje e materialeve për gazetarët dhe stafin krijues në RTSH

- Drejtoria e Arkivit i është përgjigjur kërkesave për materiale arkivore audio dhe audio-vizive me qëllim shfrytëzimi sipas kërkesave nga Njësia e Programacionit, Njësia e Lajmeve dhe Emisioneve Tematike si dhe kërkesave për akses të materialeve arkivore audio dhe audio-vizive nga palët e treta.

- Përgatitje e Materialeve për palët e treta

Përgatitja e materialeve për palët e treta në përputhje me Rregulloren e Arkivit dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Drejtues i RTSH.

- Problematikat e hasura

- Problematika kryesore është mungesa e investimeve dhe vonesa e procesit të digjitalizimit të materialeve arkivore që ndodhen në formate të teknologjisë së vjetër ku përfshihen formati: film 16 mm, Ampex 2 inch, Bosch 1 inch.
- Drejtoria e Arkivit ka një shqetësim tepër të madh në lidhje me sigurinë e File digjital të materialeve që ndodhen në storage të RTSH-së.

DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE E PROJEKTEVE

Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe e Projekteve është e përbërë nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe nga Sektori i Projekteve dhe i Administrimit të Drejtave.

- Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë:

- Është angazhuar për mbajtjen e marrëdhënieve me median publike homologe italiane RAI, me organizmat ndërkombëtare si OSBE-ja dhe me institucione dhe subjekte të tjera, marrëdhëniet me të cilat kanë interes për RTSH-në, si dhe ka ruajtur e zhvilluar më tej marrëdhëniet me përfaqësitë e huaja diplomatike, sidomos ato më të frytshmet me ambasadat e Italisë, Francës, Azerbajxhanit, Kinës, etj.
 - Ka asistuar në përpilimin dhe zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit mes RAI-t dhe RTSH-së nëpërmjet së cilës u dërgua nga RAI Paketa e Programeve Gjeneraliste për transmetim si edhe Paketa e Programeve për Fëmijë, që i janë dërguar Njësisë së Programeve për t'i përgatitur për transmetim.
 - Ka koordinuar punën, përgatitjen e dokumentacionit për transmetimin e Festivalit të 74-të të Këngës Italiane "Sanremo 2024", si dhe me kërkesë-pagesat për tarifën e transmetimit.
 - Ka bashkëpunuar me Drejtoritë e tjera të RTSH-së, në përgatitjen e dokumentacionit dhe hedhjen në sistemin zyrtar të EBU-së të gjitha materialeve të kërkuara për pjesëmarrjen në Festivalin Europian të Këngës – ESC 2024 Malmo, Suedi, duke marrë pjesë në takimin e krerëve të delegacioneve në Festivalin Europian të Këngës – ESC 2024.
 - Ka bërë rezervimin në sistemin e brendshëm të Eurovisionit të të gjithë eventeve ndërkombëtare me karakter artistik të transmetuara në RTSH si dhe ka proceduar me kërkesë pagesat përkatëse duke kontaktuar dhe informuar të gjithë anëtarët e jurisë kombëtare ESC 2024, koordinatorin teknik, zëdhënësin e pikëve si dhe noterin publik për të dhënat bankare të gjithsecilit për likuidimin e pagesave pas Eurovision Song Contest 2024 (ESC 2024).
 - Ka hartuar të gjithë kërkesë pagesat për faturat e palikujduara sipas preventivit të përgjithshëm pas mbarimit të ESC 2024, si vijon:
- (i) Juria Kombëtare, koordinatori teknik, noter publik dhe zëdhënësi i pikëve për ESC 2024.

(ii) "Shpenzime për kompozim, arranzhim dhe tekstshkrim, (Master audio) si dhe miksimi dhe masterizimi i këngës me titullin "TITAN"

(iii) "Shpenzime për performancën skenike".

(iv) "Shpenzime për vokal shoqërues në performancë".

(v) "Shpenzime për realizimin e kartolinës prezantuese të Shqipërisë".

(vi) "Shpenzime të delegacionit gjatë qëndrimit në Malmo (Suedi)".

(vii) Shpenzime për promovimin e këngës në gjashtë qytete në Evropë

- o Është angazhuar për mbajtjen e marrëdhënieve me median publike homologe italiane RAI, me organizmat ndërkombëtare si OSBE-ja si dhe me institucione dhe subjekte të tjera, marrëdhëniet me të cilat kanë interes për RTSH, si përmirësimin e marrëdhënieve me ambasadën Italiane dhe Institutin Italian të Kulturës, për rolin e RTSH-së si media partnere në eventin "Java Italiane", të organizuar nga Ambasada italiane dhe RAI.
- o Gjithashtu ka organizuar dhe ndjekur vizitën e Drejtorit të Fotografisë në RAI, z. Marco Lucarelli në përurimin e sallës Orkestrës Simfonike të RTSH-së.
- o Ka organizuar punën, përgatitjen e dokumentacionit për udhëtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së dhe Drejtorit të Marrëdhënieve me Jashtë në Asamblenë e 92-të Vjetore të EBU-së.

- Sektori i Projekteve dhe Administrimit të të Drejtave

Në mbështetje dhe zbatim të rregullores për miratimin dhe zbatimin e projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave, Sektori i Projekteve dhe Administrimit të të Drejtave ka ndjekur procedurën përkatëse për:

- o Projektet artistike "Cikël emisionesh televizive etj" me vlerë financiare nën 1% të buxhetit të përgjithshëm të RTSH-së, prodhim ekskluziv i RTSH-së.
 - a. Sipas kërkesës së Njesisë së Programeve, Njesisë së Emisioneve Tematike dhe Lajmeve dhe Departamentit të Programeve Radiofonike u përgatit dhe u ndoqwn procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve artistike - cikël emisionesh dhe / ose spektakël televiziv duke vwnw në dispozicion të Bordit Artistik dokumentacionet përkatëse, duke ofruar gjithashtu gjithë asistencen e nevojshme për hartimin e dokumentacionit administrative (deklaratat e konfliktit të interesit, procesverbali i mbledhjes dhe vendimet e Bordit Artistik) dhe për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të njoftuara.
 - b. Në referim të projekt buxhetit financiar të projekteve artistike, pas verifikimit të përputhshmërisë me librin tarifar të RTSH-së, është përgatitur dokumentacioni administrativ - financiar. Në zbatim të vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm, janë hartuar dhe nënshkruar të gjitha kontratat sipas zërave të preventivit financiar.

- Projekti artistik "Festivali i Këngës për fëmijë në RTSH", prodhim ekskluziv i RTSH-së, është zhvilluar në shtator të 2024.
- Projekti artistik "Pjesëmarrja e RTSH në Junior Eurovision Song Contest 2024", prodhim ekskluziv i RTSH-së, është zhvilluar në nëntor të 2024, në Madrid, Spanjë.
- Projekti artistik "Festivali i 63-të i Këngës në RTSH", prodhim ekskluziv i RTSH-së, është zhvilluar në datat 19, 20, 21, 22 dhe 23 dhjetor 2024 në Pallatin e Kongreseve. Sektori i Projekteve dhe Administrimit të të Drejtave ka ndjekur procedurën duke përgatitur të gjithë dokumentacionin administrativo-ligjor dhe financiar për shqyrtimin dhe miratimin e projektit artistik në Bordin Artistik, Bordin e Administrimit si dhe dhe Këshillin Drejtues të RTSH-së.
- Orkestra Simfonike të RTSH: Stina Koncertore janar-dhjetor 2024 Në kuadër të Stinës Koncertore janar-dhjetor 2024, në zbatim të vendimeve të Drejtorit të Përgjithshëm bazuar në propozimet e Orkestrës Simfonike, janë hartuar dhe nënshkruar kontratat me të gjithë dirigjentët dhe instrumentistët e ftuar, të cilët kanë interpretuar në koncertet e planifikuara.
- Bashkëpunëtorët në gjuhën e minoriteteve në kanalin RTSH 2 për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2025. Në vijim të kërkesës së Njesisë së Programeve, në muajin dhjetor 2024, janë hartuar dhe nënshkruar kontratat me të gjithë bashkëpunëtorët në gjuhën e minoritetit rom, maqedonas, grek, bullgar, serb, arumun, malazez dhe boshnjak.
- Blerja e të drejtave të transmetimit për filmat kinematografikë ndërkombëtarë, në vijim të ofertës së shoqërisë "Albatrade music and movie" sh.p.k. dhe propozimit të Njesisë së Programeve, Sektori i Projekteve dhe Administrimit të të Drejtave ka ndjekur procedurën duke përgatitur të gjithë dokumentacionin administrativo-ligjor për shqyrtimin dhe miratimin e projektit artistik në Bordin Artistik, për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës midis dy palëve si dhe ka ndjekur procedurën për kontrollin teknik të lëndës së dorëzuar, hyrjen e materialit në Arkivin e RTSH-së.
- Midis RTSH-së dhe personit fizik Ylli Pepo është nënshkruar kontrata e dhurimit për dokumentarin me titull "Tashko & Koço, një love story shqiptare". Sektori është angazhuar dhe kapunuar për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës midis dy palëve si dhe ka ndjekur procedurën për kontrollin teknik të lëndës dhe hyrjen e materialit në Arkivin e RTSH-së.
- Në zbatim të kontratës të nënshkruar midis RTSH-së dhe RAI-t është ndjekur procedura për kontrollin teknik të lëndës, hyrjen e materialit në Arkivin e RTSH-së dhe njoftimin e strukturave përkatëse për hyrjen e materialit në Arkiv, kohëzgjatjen dhe llojin e të drejtave që i kalohen RTSH-së.

DREJTORIA E AUDITIT TË BRENDSHËM

Për vitin 2024 puna e Drejtorisë së Auditit është fokusuar në realizimin e planit vjetor të miratuar nga Titullari, ku janë planifikuar misione auditimi të njësive dhe qendrave vendore audiovizive në varësi të RTSH-së.

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka kryer auditimet si mëposhtë:

1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm mbi auditimet e një viti më parë.
2. Qendra Vendore Audiovizive Korçë
3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore
4. Drejtoria Ekonomike (është ende në proces)

përsa i përket Drejtorisë Juridike dhe të Prokurimeve ky auditim është parashikuar të zhvillohet gjatë vitit 2025, për arsye se gjatë vitit 2024, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar me staf të reduktuar, kjo strukturë u plotësua gjatë muajit shtator 2024. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH gjithashtu do të realizohen në muajt në vazhdim të viti 2025 pasi raporti përfundimtar ka ardhur në muajin dhjetor të vitit 2024.

- Angazhimi dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2023

Përsa i përket angazhimeve të zbatimit të viti të kaluar kanë qënë pjesë e kontrollit

Drejtorja e Burimeve Njerëzore. Në këtë Drejtori është zhvilluar auditim i llojit përputhshmërie, dhe janë dhënë rekomandime të karakterit organizativ, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përmirësime të kuadrit ligjor. Janë dhënë 6 rekomandime, të pranuar. Përsa i takon realizimit shprehemi si më poshtë:

- Dy rekomandime të pa zbatuar - për rekomandimeve të lëna nga KLSH brenda afateve. Nuk na është vënë në dispozicion informacion lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimi dhe mos vënie në dispozicion informacione të cilat lidhen me MFK.

- Tre rekomandime të zbatuara - mbi sistemin menaxhimit të burimeve njerëzore që lidhen me përditësimin e dosjeve të punonjësve, formati i vlerësimit në punë, veprim "ndihmë financiare" ku merret miratim nga Drejtori i Përgjithshëm.

- Një rekomandim është në proces - mbi rishikim e strukturave që të veprohet mbi ligjet dhe rregullat në fuqi, duke u rishikuar dhe plotësuar regjistri i riskut, gjurma e auditit për çdo proces pune dhe po merret në konsiderat procesi i digjitalizimit për menaxhimin e burimeve njerëzore.

QVA Shkodër. Në këtë Drejtori është zhvilluar auditim i llojit përputhshmërie dhe janë dhënë 7 (shtatë) rekomandime përkatësisht mbi sistemin e administrimit, sistemin e menaxhimit të

burimeve njerëzore dhe të karakterit organizativ. Rekomandimet janë pranuar nga drejtoria. Përsa i takon realizimit shprehemi si më poshtë:

- Pesë rekomadime të zbatuara nga të cilat 3 (tre) janë rekomadime të përmirësimit të sistemeve si blerje/prokurime, paga/honorare dhe sistemet e administrimit (arkivë/magazine). Ndërsa 2 (dy) rekomadime të tjera lidhen me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore.

- Dy rekomadime të tjera kanë rënë si pasojë e ndryshimit të proceseve të punës.

Angazhimi i kontrollit në QVA Korçë janë dhënë tre rekomadime të cilat janë të pranuar nga menaxhimi dhe bazohen në sistemin e raportimit financiar dhe kontabilitet, pagat dhe shpërblimet, dhe sisteme specifike dhe operacionale të veprimtarisë së tyre mbi kuadrin ligjor.

Angazhimi i kontrollit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore ku janë dhënë tre rekomadime të cilat janë të pranuar nga BNJ dhe kanë karakterin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Përsa i përket Raportit Përfundimtar dhe Rekomadimeve të KLSH bëjmë një analizë të plotë të rekomadimeve të cilat ka lënë kontrolli, pasi sqarojmë se ndjekja dhe realizimi i tyre do të raportohet me shkrim pranë KLSH në vitin 2025, brenda 6 muajve nga ardhja në institucion.

A. Opinioni i përgjithshëm për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar)

B. Masa Organizative të cilat kanë karakter - Krijimi i udhëzimeve të qarta për procese kyçe si prokurimet, pagesat, administrimi i pasurive publike, etj. Trajnime për procedurat financiare, ligjet përkatëse dhe përdorimin e sistemeve informatike (sistemi i prokurimeve – APP). Inventarizimi dhe regjistrimi i saktë i të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme Rishikimi i kontratave të shërbimeve ose marrëveshjeve të bashkëpunimit. Rritje e transparencës dhe lehtësim i kontrollit dhe arkivimit të të dhënave. Rishikimi i përditësimi i strukturës organizative, rregulloreve dhe unifikim i pagave etj.

C. Rekomandimet për masa organizative janë 57 masa gjithsej nga të cilat duhen zbatuar:

- Menjëherë - 13 masa, nga këto 10 masa janë të pranuar dhe 3 të zbatuara

- Menjëherë dhe në vijimësi - 4 masa, nga këto 3 masa janë të pranuar dhe 1 e zbatuar

- Në vijimësi - 30 masa, nga këto 27 masa janë të pranuar, 1 pranohet pjesërisht, 1 e zbatuar dhe 1 zbatuar pjesërisht.

- Brenda 31.03.2025 - 8 masa, nga këto 6 masa janë të pranuar dhe 2 të zbatuara.

- Deri më 30.04.2025 - 2 masa të pranuar.

D. Masa për shpërblim dëmi.

Rekomandimet për masa për shpërblim dëmi janë 26 masa gjithsej nga të cilat duhen zbatuar. Për 11 subjekte janë dërguar shkresa për njohje detyrimi.

- Menjëherë - 5 masa nga këto 4 masa janë pranuar dhe 1 është në proces zbatimi.

- Brenda 31.03.2025 - 6 masa nga këto 5 masa janë pranuar dhe 1 nuk pranohet.
- Brenda 30.04.2025 - 6 masa nga këto 3 masa janë pranuar, 2 nuk pranohen dhe 1 masë është zbatuar.
- Deri më 30.04.2025 - 9 masa janë në proces.

E. Rekomandimet për masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike janë 6 masa gjithsej nga të cilat duhen zbatuar:

- Menjëherë - 1 masë të pranuar.
- Në vijimësi - 2 masa të pranuar.
- Brenda 31.03.2025 - 1 masë nuk pranohet.
- Deri më 31.03.2025 - 1 masë të pranuar.
- Brenda 30.04.2025 - 1 masë të pranuar.

F. Rekomandimet për të ardhura të munguara janë 3 rekomandime gjithsej nga të cilat duhen zbatuar:

- Menjëherë - 3 masa të cilat ndodhen në statusin në zbatim

G. Rekomandime për masa disiplinore

- Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna për 9 punonjës.
- Vërejtje për 3 punonjës.

Janë zbatuar masat disiplinore për 6 punonjës pasi pjesa tjetër është larguar nga detyra.

H. Rekomandime për punonjësit e larguar

- Lirim nga detyra për 4 punonjës.
- Zgjidhje e menjëhershme e marrëdhënieve të punës për 6 punonjës.
- Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna për 2 punonjës.

Përsa i përket Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve për Auditimin tematik "Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar i Këngës" në RTSH" të KLSH bejmë një analizë të plotë të rekomandimeve të lënë nga kontrolli.

A. Masat Organizative

Rekomandimet për masat organizative janë 3 gjithsej nga të cilat duhen zbatuar:

- Menjëherë - 1 masë të pranuar.
- Në vijimësi - 2 masa të pranuar.

B. Masa shpërblim bëmi janë 3 gjithsej nga të cilat duhen zbatuar:

- Menjëherë – 3 masa të pranuar.

C. Rekomandimet për masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike janë 2 masa gjithsej nga të cilat duhen zbatuar:

- Menjëherë – 1 masë të pranuar.

- Menjëherë dhe në vijimësi – 1 masë të pranuar.

Gjatë kësaj kohe, i është kushtuar vëmendje procesit të vlerësimit paraprak të riskut, theksojmë se në këtë drejtim ka vend për përmirësime.

DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ONLINE DHE WEB

Drejtoria ka ushtruar funksionin e saj duke patur në fokus:

- **Promovimin e programeve RTSH** në rrjetet sociale dhe platformat online.
 - **Rritjen e audiencës** përmes strategjive të reja të komunikimit.
 - **Shpërndarjen e informacionit** përmes faqes zyrtare dhe në mënyrë korrekte, të sakte e të balancuar me qëllim arritjen tek një publik sa më i gjerë.
 - **Bashkëpunimin me Drejtorinë e Shitjeve dhe Promocionit** duke rritur vizibilitetin dhe ndikimin e RTSH në platformat online dhe rrjetet sociale.
 - **Rritjen e të ardhurave përmes monetizimit të videove në platformën youtube.**
- **Performanca dhe Analiza Digjitale**

Drejtoria ka realizuar një monitorim të thellë të angazhimit të audiencës në të gjitha platformat digjitale, duke shfrytëzuar analiza të avancuara për të optimizuar përmbajtjen.

- **YouTube:** RTSH ka arritur mbi **243,261 abonentë** dhe ka regjistruar 110.5M shikime, 107% më shumë sesa periudha 31 Dhjetor 2022 – 2023, dhe ka regjistruar 114.2K abonentë në raport me të njëjtën periudhë
- Të ardhurat në platformën youtube për vitin 2024 kanë qenë në nivelin **106,713.58 Euro**, në përqindje **31.5%** më shumë krahasuar me vitin 2023.
- **Facebook & Instagram:** Strategjitë e reja në përmbajtjen vizuale, menaxhimin më të mirë të fluksit të postimeve kanë rritur ndërveprimin dhe ndjekësit.
- **TikTok:** Përgjatë vitit 2024 në platformën Tiktok, shikimet e videove kanë arritur në 736,404,614, ndërkohë që shikimet që i takojnë profilit kanë qënë 3,036,537. Përsa u takon pëlqimeve, kanë qënë të regjistruara 11,490,761 të tilla, ndërkohë që kanë komentuar në profilin e RTSH në TikTok 777,624 ndjekës.

- **Website RTSH:** Aktiviteti në website, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Informacionit, ka përfshirë një mbulim të gjerë të ngjarjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, eventet kulturore si **Festivali i Këngës**, dhe zhvillimet e sportit, duke përfshirë ndeshjet e kampionatit shqiptar të futbollit. Informacioni i pasqyruar në të ka qënë i saktë, korrekt dhe i balancuar.
- **Spotify:** Rreth 12 mijë persona kanë dëgjuar episodet e katalogut të RTSH-së në platformën Spotify që nga momenti kur RTSH u bë pjesë e saj në Prill 2024. 1,947 orë kanë konsumuar njerëzit duke dëgjuar episodet e gjendura në katalog e RTSH-së në Spotify. Që nga momenti i prezencës në Spotify, RTSH numëron 386 ndjekës.
- **Përmbajtja dhe risi digjitale**

Gjatë vitit 2024, RTSH ka investuar në përmbajtje inovative dhe personalizuar për audiencën online.

- **Optimizimi për Rrjetet Sociale:** Janë krijuar **video të shkurtra** për formate si **reels dhe shorts**, për të tërhequr më shumë shikues.
- **Transmetimet online Live:** RTSH ka zgjeruar transmetimet live në platformat online, duke përfshirë evente të rëndësishme dhe programe politike e kulturore.

DREJTORIA E GRAFIKËS

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Grafikës e Radio Televizionit Shqiptar ka njohur një zhvillim cilësor, duke sjellë një nivel të ri profesionalizmi dhe kreativiteti në përgatitjen e materialeve vizuale. Përmes një stili gjithnjë e më origjinal dhe përdorimit të teknologjive moderne, grafika e RTSH-së është përafëruar me standardet bashkëkohore të televizioneve publike në Europë.

- **Stil grafik unik dhe i përshtatur për çdo emission**
- Gjatë këtij viti janë realizuar faqosje grafike për mbi 60 emisione të ndryshme, duke zhvilluar për secilin një identitet vizual të dedikuar.
- Këto paketa grafike përfshijnë: hyrje (intro), titra të lëvizshëm (lower thirds), kalime mes rubrikave (bumpers), tabela informuese, credits fundore dhe elemente të animuara.
- Grafika nuk u trajtua si shabllon, por si pjesë përbërëse e identitetit të çdo programi, duke sjellë një shumëllojshmëri stilesh: minimal, klasik, dinamik, modern apo rinor – sipas rastit.
- **Integrimi i inteligjencës artificiale në punën creative**
- Gjatë vitit 2024 nisi dhe u zgjerua përdorimi i inteligjencës artificiale në përgatitjen e elementeve vizuale. U përdorën mjete si MidJourney, RunwayML dhe Kling AI për të krijuar sfonde, tekstura, skena të animuara dhe ilustrime artistike.
- Këto teknologji ndihmuan në:
 - Shpejtimin e procesit të krijimit grafik
 - Shtimin e alternativave vizuale gjatë konceptimit

- Rritjen e cilësisë dhe veçantisë në prezantimin grafik të RTSH-së.
- Në mënyrë të veçantë, AI u përdor për identitetin e RTSH Film dhe për projekte eksperimentale me ngjyra artistike apo tematika të veçanta. Gjithashtu dhe për të gjeneruar posterat e spotify të cilat deri me tani janë 230 cope.

- **Bashkëpunim më i afërt me redaksitë e RTSH-së**

- Grafika ka qenë më aktive dhe më e përfshirë në procesin editorial, duke punuar në koordinim të drejtpërdrejtë me gazetarët dhe redaksitë përkatëse.
- Kjo solli përmirësim në komunikim dhe në përshtatjen e dizajnit me nevojat reale të përmbajtjes, si për lajme, sport, kulturë, emisione edukative apo dokumentarë.
- U krijuan gjithashtu disa identitete të përbashkëta për rubrika të përsëritshme, që ndihmojnë në ndërtimin e një imazhi të njohshëm për publikun

- **Problematika të hasura**

Pavarësisht përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit, departamenti përballlet me disa sfida teknike dhe strukturore që ndikojnë ndjeshëm në cilësinë dhe efikasitetin e punës së përditshme:

Pajisje të vjetruara teknologjike: Kompjuterat aktualë, edhe pse funksionojnë, datojnë nga vitet 2008–2010 dhe nuk përmbushin më kërkesat teknike për programet bashkëkohore të dizajnit dhe animacionit grafik. Vetëm dy kompjutera në sektorin e grafikes i përmbushin keto kërkesa plotësisht. Po ashtu, pajisje, si kufjet, mouse dhe tastiera janë shumë të vjetra, duke kufizuar performancën dhe efikasitetin gjatë punës me programet e fundi

Vonesa në përpunim grafik: Pajisjet ekzistuese shkaktojnë kohë të gjata në procesin e prodhimit, gjë që ndikon negativisht në afatet kohore të projekteve dhe në përgatitjen e grafikave On Air për edicionet informative.

DREJTORIA E TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e IT-së ka konsoliduar operacionet bazë duke synuar arritjen e një disponueshmërie të lartë të sistemeve kritike dhe eficiencë në ofrimin e shërbimeve teknike. Në bashkëpunim të ngushtë me njësitë tjera të RTSH-së u realizuan ndërhyrje planifikuese për përmirësimin e rrjeteve lokale në degët kryesore (p.sh., RTSH 24 dhe platforma Web), ku rezultoi ulje e vonesave në qarkullimin e të dhënave dhe përmirësim i performancës së aplikacioneve të brendshme. Administrimi proaktiv i pajisjeve ekzistuese (serverë, storage, etj.) siguroi stabilitet operativ në nivele mbi 99% uptime në shërbimet kyçe, duke reduktuar rastet e ndërprerjeve jo-planuara.

Në fushën e komunikimit elektronik institucional, shërbimi i postës mbeti i pandërprerë dhe me integritet të ruajtur; politika të avancuara filtrimi dhe monitorimi ishin efektive në bllokimin e rreth 60 email-eve të dyshimta ose me malware gjatë vitit, çka kontriburoi në mbrojtjen e përdoruesve dhe mbajtjen e reputacionit të domenit të RTSH-së. Proceset e backup-it dhe arkivimit

u forcuan përmes zbatimit të teknologjisë LTO për ruajtje offline, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arkivit: kjo masë siguron mbrojtje nga humbja e dhënash afatgjatë dhe lehtëson rikthimin e tyre në rast nevojë, duke vendosur baza për rritje të kapaciteteve sipas volumit në rritje të materialeve multimediale.

Ndihma teknike e ofruar nga Help Desk-i dhe ekipi i infrastrukturës u menaxhua me efektshmëri, ku mesatarisht kërkesat e nivelit I u zgjidhën brenda pak orësh; stafi teknik asistoi në konfigurimin e pajisjeve të reja dhe në mirëmbajtjen e stacioneve të punës, duke reduktuar kohën e ndërprerjeve për përdoruesit. Për ngjarje të veçanta si Festivalin e Këngës, Drejtoria e IT-së ofroi mbështetje të posaçme për sistemin e televotimit—përfshirë teste para eventit, sigurimin e serverëve rezervë dhe monitorimin në kohë reale—që garantuan besueshmëri dhe integritet në procesin e votimit.

Megjithatë, sfidat e vitit ishin evidente: prodhimi i vazhdueshëm multimedial shkaktoi nevojë të përhershme për zgjerim të kapacitetit të ruajtjes (storage), ku propozimet për blerje të pajisjeve shitesë mbetën ndër prioritetet kryesore. Vonesa në shkëmbimin e pajisjeve të amortizuara ndikoi në ritmin e disa ndërhyrjeve, duke kërkuar monitorim të shtuar dhe riparime emergjente, ndërsa mungesa e një plani të përditësuar për zëvendësim të inventarit teknik imponoi stres mbi burimet ekzistuese.

Në aspektin e sigurisë kibernetike, infrastruktura ekzistuese bazohej në një firewall të gjeneratës së vjetër që nuk ofronte mbrojtje të shtresuar me kapacitete të avancuara IDS/IPS, menaxhim qendrorizuar të politikave dhe integrim me një platformë SIEM. Kjo nxori në pah rrezikun për sulme të mundshme dhe nevojën urgjente për investim në pajisje të reja të sigurisë, që të lehtësojnë kontrollin e trafikut sipas politikave institucionale, mbrojtjen proaktive ndaj kërcënimeve, dhe aftësinë për raportim dhe analizë qendrore.

Nga ana e stafit, Drejtoria shfaqti angazhim të lartë në përmbushje të detyrave ditore dhe ofroi reagim profesional ndaj incidentëve, por sfidat komplekse të sigurisë kërkojnë shtim të kapaciteteve njerëzore me profil të specializuar në fushën e kibernetikës (p.sh., analistë SOC, ekspertë në menaxhimin e incidentëve, etj.). Nevojitet edhe një plan trajnimi dhe certifikimi për stafin ekzistues, si dhe rekrutimi i të paktën një ose dy specialistëve të sigurisë për të strukturuar një qendër të vogël operacioni sigurie (SOC) brenda Drejtorisë.

Si përfundim, rekomandohet vijimi i modernizimit të infrastrukturës me prioritet investimin në një firewall të gjeneratës së re dhe në zgjidhje SIEM, zgjerimin e kapaciteteve të storage-it sipas planit të rritjes së prodhimit multimedial, dhe krijimin e një strukture të dedikuar sigurie kibernetike (përfshirë procese incidente, monitorim 24/7 dhe trajnime). Një plan i qartë zëvendësimi të pajisjeve të amortizuara, së bashku me një buxhet të mirëmenadur për blerje të ri-infrastrukturës, do të sigurojë që qëndrueshmëria, performanca dhe mbrojtja e sistemeve të RTSH-së të jenë në përputhje me kërkesat aktuale operacionale dhe të reduktojnë rreziqet teknike në të ardhmen.

ORKESTRA SIMFONIKE E RTSH

Në përputhje me statusin e RTSH-së, Orkestra Simfonike ka për mision të promovojë kulturën dhe artin muzikor nëpërmjet interpretimit të veprave të rëndësishme të repertorit shqiptar dhe botëror, të nxisë edukimin artistik të publikut si dhe të kontribuojë në zhvillimin e jetës kulturore në Shqipëri. Me punën e saj Orkestra Simfonike është një model i cilësisë artistike dhe një urë komunikimi mes publikut dhe muzikës klasike, përmes koncerteve, bashkëpunimeve institucionale dhe përfshirjes në aktivitete të rëndësishme kulturore kombëtare.

Orkestra Simfonike e RTSH-së ka kryer detyrën e saj me përgjegjësi të lartë dhe me korrektesë në interpretimin në të gjitha koncertet dhe aktivitetet artistike si pjesë e stinës koncertore 2024 –2025. Stina koncertore u realizua me sukses të plotë duke u mbështetur në realizimin e një programi të nivelit të lartë artistik dhe profesional.

Gjatë vitit 2024, Orkestra Simfonike e RTSH realizoi:

- ☐ 23 koncerte simfonike si pjesë e stinës koncertore;
- ☐ 10 koncerte dhe projekte me formacione më të reduktuara orkestrale;
- ☐ Angazhime në të gjitha aktivitetet artistike të organizuara nga institucioni.

Gjatë stinës koncertore 2024, Orkestra Simfonike e RTSH-së pati të ftuar emra të njohur të dirigjimit dhe solistëve nga Evropa dhe bota.

Ndër veprat më të spikatura të vitit të interpretuara nga OSRTSH janë:

- ☐ Simfonia nr. 7 e Bruckner, në dirigjimin e Daniel Geiss nga Gjermania;
- ☐ Simfonia nr. 4 e Mahler, në dirigjimin e Facundo Agudin nga Zvicra.

Të dyja këto koncerte u vlerësuan për nivelin e lartë artistik, teknik dhe profesional.

Dirigjentë të tjerë të huaj të ftuar gjatë vitit të cilët realizuan koncerte me nivel të lartë ishin:

- ☐ Clara Baget
- ☐ Levi Hammer (dirigjent dhe pianist solist)
- ☐ Konako Abe
- ☐ Eno Koço
- ☐ Vito Clemente
- ☐ Emir Krantja
- ☐ Leonardo Quadrini
- ☐ Simon Krcic

Për të forcuar lidhjet artistike, OSRTSH ka realizuar marrëveshje me Teatrin e Operas dhe Baletit si dhe Universitetin e Arteve.

Në kuadrin e këtyre bashkëpunimeve, instrumentistët e OSRTSH zhvilluan koncerte të përbashta me instrumentistët e TOB-it dhe pedagogë e studentë të Universitetit të Arteve, duke krijuar hapësira të reja për shkëmbime artistike dhe zhvillim profesional.

Përveç stinës koncertore 2024, Orkestra punoi me përpikmëri dhe profesionalizëm në përgatitjen e Festivalit të 63-të të Këngës në RTSH, një ngjarje që kulmoi me sukses ku orkestra simfonike kishte një rol kyç në këtë aktivitet me interpretimin e saj live.

Gjithashtu orkestra organizoi një mbrëmje Gala në fundvit, e cila synohet të kthehet në një traditë si një koncert më festiv dhe shumë i veçantë, duke pasuar shembullin e orkestrave simfonike në mbarë botën. Në këtë koncert ishin ftuar të interpretonin tenorët Granit Musliu nga Kosova, Rodrigo Trosino nga Italia, Vitaliy Kovalchuk nga Ukraina.

Përsa më sipër gjatë vitit 2024, Orkestra Simfonike e RTSH ka treguar angazhim maksimal dhe cilësi artistike në të gjitha koncertet e realizuara prej saj me vepra të zgjedhura nga autorë të njohur dhe periudha të ndryshme historike dhe stilistike.

Të gjitha këto koncerte janë transmetuar në rrjetin DVB-T2 të Radio Televizionit Shqiptar.

Synimi për të ardhmen është ruajtja e kësaj tradite të suksesshme dhe pasurimi i jetës artistike në Shqipëri duke realizuar koncerte me nivel të lartë artistik ku do të interpretohen vepra nga emra të njohur të botës së muzikës klasike nën drejtimin e profesionistëve të fushës.